Shtete e ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në periudhën prej 1991 deri në vitin 2001 ishin përfshirë në konfliktin e armatosur i cili karakterizohet nga shkelje të rënda sistematike dhe masive të të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare. Konfliktet e armatosura janë kryer në Slloveni (Qershor - korrik 1991), Kroaci (1991 -1995), Bosnje dhe Hercegovinë (1992-1995), Kosovë (1998-1999) dhe Maqedoni (Janar - Gusht 2001) rezultonin në humbjen e rreth 135,000 jeta, dhjetëra mijë të plagosur ose të viktimave të formave të tjera të dhunës.¹ Rreth 10,000 persona janë ende të pagjetur,² duke përfshirë një numër të civilëve, fëmijëve, grave dhe personave të moshuar që nuk kanë marrë pjesë në luftë.

Lufta në ish-Jugosllavi pas vete la qytete të tëra të shkatërruara dhe djegura, persekutimin dhe dëbimin e qindra mijëra civilëve, pjesë të mëdha të pastruara etnikisht në Kroaci, Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë, duke krijuar hapësirë për zgjerimin e retorikës nacionaliste dhe manipulimin e ngjarjeve dhe rrëfimeve të kaluarës së

afërm. Trashëgimia e së kaluarës nga lufta është një barrë e rëndë për të gjitha shoqëritë post-jugosllave të cilat mbeten thellësisht të ndara në nivel nacional dhe të cilat gjithashtu janë duke u përpjekur që shtetet e tyre ti rregullojnë sipas parimeve të një demokracie funksionale. Kjo çështje është veçanërisht e ndjeshme në Serbi, në të cilën pas përfundimit të regjimit autoritar të Slobodan Millosheviqit dhe marrjes së pushtetit pas ndryshimeve të pesë Tetorit mbetet një tregim dominuese që përfshin mohimin e krimeve, ndërsa populli serb qëndron si viktimë më e madhe. Diskursi i tillë bëhet më kompleks kur kemi parasysh se qëndrimi zyrtar i Serbisë që nuk ka marrë pjesë në luftërat në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë si dhe auto-viktimizimi i popullit të vet, mbështetet në idenë thujse mitike të serbëve³ si një popull i cili historikisht është dënuar të jetoj në kufijtë e botës dhe për këtë arsye pëson.

Serbia ka pasur shumë mundësi që me kapacitet të plotë dhe në nivel institucional ti qaset procesit të ballafaqimit me të kaluarën duke zbatuar mekanizmat e drejtësisë tranzicionale⁴ në mënyrë që të krijohen parakushtet

1 Ewa Tabeau, "Lufta në numër - Humbjet demografike në luftërat në ish-Jugosllavi 1991-1999", Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Beograd, 2009.

2 *Ibid.*

3 Tim Judah, "Serbët - Historia, miti dhe shkatërrimi i Jugosllavisë", Yale University Press, 2000.

4 Sipas Qendrës Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (QNDT), Drejtësia tranzicionale është një fushë e cila studion mënyrat e trajtimit të shkeljeve të mëparshme të të drejtave të njeriut në shoqëritë në tranzicion, është një nga instrumentet më të rëndësishme të procesit të demokratizimit nën udhëheqjen e organizatave ndërkombëtare sepse mund të funksionojë si një katalizator efektiv për pajtimin pas konfliktit dhe stabilizim.

për vërtetimin e fakteve mbi krimet e kryera gjatë luftërave në ish-Jugosllavi si dhe marrjen e përgjegjësisë institucionale për krimet e kryera nga Sllovenia deri në Kosovë. Megjithatë, deri tani mekanizmat e drejtësisë tranzicionale në Serbi zbatohen kryesisht nën presionin ndërkombëtar dhe opinionit publik, paraqiten si “kushtet që duhet ti plotësojmë në procesin e integritetit në BE dhe jo për nevoja reale për t’u marrë me të kaluarën të kohës së luftës. Mungesa e të kuptuarit të drejtësisë tranzicionale dhe qëndrimi pasinqortë e autoriteteve ndaj kësaj çështjeje ka çuar në krijimin e kulturës së përgjithshme të mohimit të krimeve të luftës dhe rolin e Serbisë në luftërat në ish-Jugosllavi.

Mekanizmat të drejtësisë tranzicionale që synojnë shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut të kryera në të kaluarën janë: mekanizmat për përcaktimin e përgjegjësisë (të tilla si gjykimet para gjykatave nacionale dhe ndërkombëtare), mekanizmat për themelimin e së vërtetës, (të tilla si komisionet për të vërtetën, hapja e arkivave, etj.), mekanizmat për kompensimin dhe njohjen e vuajtjeve të viktimave (reparacioneve) dhe mekanizmat për parandalimin e përsëritjes së krimeve (të tilla si reformat institucionale, siç janë ilustrimet dhe verifikimet, etj.). Mungesa e vullnetit politik dhe mbështetja joadekuatë e politikës institucionale janë arsye të dështimit për të zbatuar këto mekanizma në Serbi.

Themelimi i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (ICTY)⁵ në vitin 1993 është menduar që do të kontribuojë në sjelljen e atyre që janë përgjegjës para drejtësisë, si dhe një përpjekje për të vendosur pajtimin në mes të shteteve të ish-Jugosllavisë. Megjithatë, një numër i vendimeve të pafajësisë, siç janë Gotovina dhe Haradinaj ishin një pasqyrë e gjendjes në rajon: shumica e qytetarëve të Kroacisë dhe Kosovës vlerësuan pozitivisht këtë vendim,

ndërkohë që qytetarët e Serbisë forconin qëndrimin që tribunali është anti-serb dhe i njëanshëm⁶. Në anën tjetër shfaqësimi i Perishiqit kishte një jehonë krejtësisht ndryshe në rajon⁷.

Përveç kësaj, përshtypja kryesore e gjyqimeve të krimeve të luftës para gjykatave në Serbi është se aktgjykimi nuk ka sjellë drejtësi për viktimat, as publiku Serb nuk është i informuar sa duhet në lidhje me krimet e kryera nga forcat ushtarake dhe policore të Serbisë 1991-2001. Hulumtimi i opinionit publik⁸ vetëm konfirmon diskursin përgjithësisht të pranuar dhe kështu shumica e qytetarëve të Serbisë (82%) nuk kanë dijeni të plotë mbi punën e Prokurorisë për Krime Luftë.

Këto procese kanë çuar deri aty që brezi i ri kryesisht i lindur para ose gjatë luftës, në ish-Jugosllavi kanë një nivel të lartë të paragjyqimeve dhe jo tolerancës ndaj tjetrit dhe të ndryshme ndërsa qëndrimi ndaj së kaluarës së afërt të themeluar në bazë të rrëfimeve apo narrativeve të përshtatura në librat⁹ e historisë dhe punës propagandistike të mediave të orientuara nacionale. Prandaj, fakti se në ish-Jugosllavi, ka njerëz të rinj të cilët janë të gatshëm për të pranuar faktet, të ballafaqohen me ta, dhe të përpiqen për të kontribuar në procesin e pajtimit, është një dijeni frymëzuese për të ardhmen e shoqërive post-konfliktive të Ballkanit Perëndimor.

Tema e këtij punimi është aktivizimi i të rinjëve përmes veprimit të grupeve rinore, OJQ-ve dhe të rinjëve të partive politike në procesin e zhvendosjes dhe Koalicionit për themelimin e Komisionit Rajonal për vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në ish-Jugosllavi nga 1991 deri 2001¹⁰ (KOMRA). Është e rëndësishme për të kuptuar veprimin e tyre sepse pikërisht ky komisioni rajonal ishte direkt i lidhur me temën e punimit.

5 Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë është një gjykatë e Kombeve të Bashkuara e themeluar në vitin 1993, mandati i të cilës përfshin krimet e kryera gjatë konfliktit në Ballkan të viteve 1990 - më poshtë në tekst ICTY.

6 Shih portalin online www.blic.rs internet 16.11.2012. Titulli: “Vendimi Skandaloz: Gotovina dhe Markaq të liruar, Stuhia sikur nuk ishte” (qasur më 16.07.2015).

7 Shih portalin online www.jutarnji.hr të 02.03.2015 Titulli: “?! Aktgjykim lirues Perishiqit: Ka organizuar agresion, por nuk është fajtor për krimet” (qasur më .07.2105).

8 Studim “Qëndrimet ndaj çështjeve të krimeve të luftës, ICTY dhe gjyqësori kombëtar” e, Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut dhe Misioni i OSBE-së në Serbi, 2011.

9 Studimi “Analiza e përmbajtjes së teksteve shkollorë të historisë në Serbi në lidhje me luftërat në ish-Jugosllavi, në ndriçimin e fakteve të përcaktuara nga ICTY,” Fondi për të Drejtën Humanitare 2015.

10 Më shumë për KOMRA shihni linkun www.rekom.

Në punim do të prezantohen aktivitetet e të rinjëve përmes katër qasjeve metodologjike: aktivizimit, arsimit, përkujtimit dhe iniciativës rajonale. Këto katër metoda tregojnë përpjekjet e të rinjëve për të marrë një qasje ndërdisiplinore për pjesëmarrje aktive në tranzicionin demokratik të shoqërisë së tyre dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në krijimin e një perceptimi të ndryshëm të shkaqeve dhe rrjedhën e ngjarjeve tragjike që ndodhën gjatë viteve 1990. Me analizën e tyre ofrohet një pasqyrë e plotë e aktiviteteve të kryera nga të rinjtë në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe të arriturat në kuadër jo-institucionale.

Edhe pse grupet e të rinjëve apo individë të cilët janë aktivë në komunitetet e tyre ekzistojnë në të gjitha vendet, ky punim paraqet vetëm aktivitetet e kryera nga të rinjtë në Serbi dhe të grupeve siç janë : Lëvizja e aktivistëve Nisma Ime¹¹ Grupi i të rinjëve të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut¹² dhe Këshilli të të Drejtave të Njeriut Partisë Demokratike Liberale¹³. Përmes veprimeve të tyre si dhe disa aktivitete individuale, ne do të përpiqemi të shohim motivet e tyre, metodat dhe arsyet për luftën për drejtësi dhe një shoqëri më të mirë. Gjithashtu, subjekt i këtij punimi do të jetë aktiviteti rinor në procesin e avokimit për formimin e KOMRA-s, përsëri nga perspektiva e Serbisë.

Drejtësia Tranzicionale dhe të rinjtë

Çështja e marrëdhënieve të drejtësisë tranzicionale dhe të rinjtë është një nga çështjet që i ipet pak ose vëmendje joadekuate në kuadër teorik të kësaj disipline, si dhe në praktikën krahasuese. Megjithatë, kjo marrëdhënie komplekse gjithnjë bëhet më shumë e rëndësishme, duke pasur parasysh që të rinjtë në vendet e konfliktit dhe pas konfliktit janë ata që nisin ndryshimet shoqërore dhe nxisin proceset të cilat rezultojnë në tranzicionin demokratik të shoqërisë. “Megjithëse çdo kontekst është unik, çdo tranzicion politik ose post-konflikt e shënon të paktën një karakteristikë të përbashkët, e cila është pikërisht trashëgimia e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut”¹⁴. Ky

definicion mund të shërbejë si një hyrje e mirë në kontekstin politik dhe social në të cilin të rinjtë në Serbi, si dhe në vendet e tjera të ish-Jugosllavisë, gjinden pas luftërave që ndodhën gjatë dekadës së fundit të XX dhe në fillim të shekullit XXI.

Pas një dekade (1990-2000) të luftërave, regjimit autokratik, papërgjegjshmërisë institucionale, izolimit dhe mungesës së shpresës ekonomike, fillimit të tranzicionit demokratik i cili ndodhi pas ndryshimeve të Tetorit në vitin 2000 dhe krijimin e institucioneve demokratike dhe procedurave, që është një parakusht për krijimin e kushteve për zbatimin e mekanizmave të drejtësisë tranzicionale dhe të filloji procesi i ballafaqimit me të kaluarën.

Mungesa e vullnetit politik të institucioneve cilat janë përgjegjëse për zbatimin e masave të drejtësisë tranzicionale reflekton në punën e tyre, në mënyrë që në periudhën që pasoi ndryshimet demokratike mungonte mbështetja popullore për vërtetimin e fakteve dhe të emërohen përgjegjësit, duke rezultuar me largimin e një procesi të mirëfilltë të ballafaqimit me të kaluarën.¹⁵

Një çështje e rëndësishme është perceptimi i idesë së drejtësisë tranzicionale dhe mungesa themelore e të kuptuarit dhe për të krijuar një përmbajtje krejtësisht ndryshe që është bllokuar në një kuptimin semantik. Domethënë, në qoftë se e pyesim qytetarët të rëndomtë në Serbi se çfarë nënkuptohet me konceptin e drejtësisë tranzicionale, më shumë gjasa që do të marrim përgjigjen që ajo përcakton situatën ku një qytetarit gjatë privatizimit të kompanisë nuk janë të privuar disa të drejta, kështu që për shembull nuk është larguar në mënyrë të paligjshme apo nuk ju kanë mohuar të drejtat e tjera ekonomike apo sociale. Në mënyrë të ngjashme, një qytetar i rëndomtë nën termin tranzicion përfshin shitjen e pronës shoqërore të pronarëve të rinj, duke i dhënë këtij termi një konotacion negativ. Nga ana tjetër, koncepti i drejtësisë tranzicionale si disiplinë “i referohet një sërë masash gjyqësore dhe jo-gjyqësore cilat janë zbatuar nga vende të ndryshme në përpjekje për të

11 Më shumë për Nisma Ime shihni www.yihr.org.

12 Më shumë për Grupin e të rinjëve të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut shihni www.helsinki.org.rs.

13 Më shumë për Këshillin e të Drejtave të Njeriut i PLD shihni www.ldp.rs.

14 Mark Freeman, “Çfarë është Drejtësia Tranzicionale?”, Forumi për Drejtësi Tranzicionale 1, 2007, f. 7

15 Konferenca “Ballafaqimi me të kaluarën në Serbi: Çfarë tutje?”, Organizuar nga Fondi “Biljana Kovačević-Vučo:” Fondi “Heinrich Boll” dhe Qendra për Dekontaminim Kulturor, 19-20. janar 2012.

korrigjuar trashëgiminë e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut¹⁶, e përdorur nga disa organizata joqeveritare dhe individë që drejtësia tranzicionale është pjesë së preferencës profesionale dhe strategjike.

Përveç çorientimin terminologjik, gjë tjetër “që krijon huti” në lidhje midis drejtësisë tranzicionale dhe të rinjëve, është nevoja e tyre që për këtë objekt veprimi një disiplinë që nuk paraqet fushëveprimin tipik e interesave të të rinjëve në mes 18 dhe 30 vjeç. Përgjigje në shkaqet dhe motivet e krijimit të këtyre lidhjeve duhet kërkuar në dy hipotezat - kureshtje dhe përgjegjësisë politike. Kureshtja tek të rinjtë është e natyrshme; në lidhje me këtë në përvojën krahasuese ne kemi shembullin e të rinjëve gjerman të cilët në fund të viteve të gjashtëdhjeta bëjnë pyetjen: “Çfarë ke bërë në luftë, baba?”¹⁷ deri tek artikulli i çështjes në kuadër të shoqërisë së sotme të Ballkanit Perëndimor si një slogan – Ta dimë se çfarë na ka ndodhur ! Sigurisht, ky fenomen i “kureshtje rinore” është në lidhje me situatën në të cilën jetojmë sot por edhe ekzaminimit kritik të së kaluarës së afërme dhe faktet që kanë interpretime¹⁸ të ndryshme në vendet fqinje.

Një tjetër hipotezë që flet për motivet e krijimit të këtyre lidhjeve është një përgjegjësi politike. Të rinjtë janë të vetëdijshëm se ata nuk janë dhe nuk mund të jenë përgjegjës për diçka që ka ndodhur kur ata ishin 3, 7 apo 11 vjeç. Sigurisht që koncepti i fajësisë është diçka individuale e jo kolektive i përfaqësuar sot në mbarë botën. Çfarë atëherë do të përbëhet nevoja e rinjëve që të luftojnë për diçka mbi ndonjë bazë që nuk mund të mbajnë përgjegjësi? Përgjigja qëndron në të kuptuarit e konceptit të përgjegjësisë politike, që do të thotë se të rinjtë sot kanë mundësi për tu distancuar nga politika që është udhëhequr në emër të shtetit apo popullit cilit i përkasin që përfundimisht mos të bëhet pjesë e shumicës që mohojnë ose nuk pranojnë krimet e kryera gjatë viteve 1990. Edhe në këtë fushë ka shembuj nga përvoja e vendeve të tjera pas konfliktit dhe në tranzicion nder cilat

theksohen, demonstratat studentore në vitin 1968 në të gjithë Evropën, dimensione këto që pikërisht arrijnë në Gjermani. Në vitin 1968 në Gjermani, duke kërkuar demokratizimin e shoqërisë, që ka të bëjë me të kaluarën e luftës dhe procesin e denacifikimit, paraqet momentin historik në zhvillimin e shoqërisë gjermane të pasluftës. Prandaj, vetëm ndërlihdja e kuriozitetit dhe përgjegjësisë politike si bazë e shkakut të lidhjes mes drejtësisë tranzicionale dhe rinisë, sublimon nxitjen e të rinjëve për të marrë barrën e të kaluarës së luftës dhe të merren me të.

Aktivizmi

“Aktivizimi i të rinjëve paraqet një angazhim shoqëror i të rinjëve të mbledhur rreth një ideje të përbashkët e cila me anë të rrjetit të përbashkët dhe zbatimit të projekteve të caktuara për qëllim ka përmirësimin e cilësisë së jetës për të rinjtë dhe adresimin e çështjeve relevante duke kontribuar për shoqërinë, si në bashkësi lokale ashtu dhe në nivel shtetëror.”¹⁹ Ky lloj i qasjes metodologjike është karakteristikë e të rinjëve edhe pse numri i të rinjëve të cilët janë aktiv në shoqërinë e Serbisë është më i ulët duke krahasuar me vendet e tjera në tranzicion.²⁰

Rinia është rebelim i pashmangshëm për çdo gjë që është e imponuar, e padrejtë dhe asaj që nuk është normale. Kanalizimi i entuziazmit rinor dhe vullnetit për të qenë qytetarë aktivë që do të kontribuojnë në ndryshimet në shoqëri, do ta shqyrtojmë nga pikëpamja e Lëvizjes aktiviste Nisma Ime si dhe përmes aksioneve të realizuara nga kjo lëvizje në vitin 2015. Lëvizja aktiviste Nisma Ime në shkurt të vitit 2015 në Parkun Pioner në Beograd organizoi një protestë të quajtur “Hetim, jo medalje”,²¹ me rastin e dhënies së dekoratës shefit të shtabit të përgjithshëm të ushtrisë së Serbisë, gjeneralit Dikoviç. Ndarjen e dekorimit e kreu Presidenti i Serbisë, Tomislav Nikoliç, me rastin e Sretenja, Ditës së Republikës së Serbisë. Ndarja pësoi menjëherë pas

16 <https://www.ictj.org/about/transitional-justice> (qasur më 16.07.2015).

17 Arsyeja për sloganin është një film amerikan nga viti 1966 i quajtur “Çfarë ke bërë në luftë baba”, në regjin Blejk Edwards.

18 Për shembull, në ish-Jugosllavi ekzistojnë krejtësisht emërtimet të ndryshme të luftërave gjatë viteve 1990, kështu që kroatët e quajnë Lufta atdhetare, serbët në Republikën Srpska Luftëra mbrojtëse patriotike, boshnjakët e quajnë agresion në Bosnjë dhe Hercegovinë.

19 Hulumtim i opinionit publik “Aktivizmi personal dhe social i të rinjëve në Serbi”, CESID dhe Ministria e Rinisë dhe Sportit të Republikës së Serbisë, Beograd, 2007, f. 18 ibid f.27.

20 Ibid, f.27.

21 Më shumë për protestën: <http://www.yihr.rs/bhs/istraga-a-ne-orden/> (shikueshmëria 16.07.2015.).

publikimit të “dosjes Rudnicë”, që u botua nga Fondi për të Drejtën Humanitare në të cilin theksohen pretendimet në përfshirjen e gjeneralit Dikoviç në krimet kundër civilëve në Kosovë në prill dhe maj të vitit 1999, pasi që Dikoviç në atë kohë ishte komandant i Brigades së motorizuar 37. Ndarja e dekoratës u përcoll me deklaratën e Nikoliqit, në të cilën ai “rekomandon” prokurorin për krimet e luftës të “jetë i kujdesshëm se çfarë gërmon”²², duke ndikuar drejtpërdrejt në organet gjyqësore dhe duke mbështetur sistemin e pandëshkueshmërisë, si dhe duke u tallur me viktimat e luftës në Kosovë. Me këtë veprim, Nisma Ime ka tërhequr vëmendjen për ngjarjen e përmendur, duke shpjeguar se kjo është një fyerje për qytetarët e Serbisë të cilët kërkojnë që para gjykatës të gjithë janë të njëjtë, duke kërkuar një hetim penal duke pasur parasysh që dosja e lartpërmendur përmban një dyshim të arsyeshëm se gjenerali Dikoviç ka bërë disa aktivitete kriminale. Vetë aksioni mbledhi së bashku rreth 150 njerëz të cilët protestuan në Parkun Pionir²³ në momentin kur në ndërtesën e Presidencës (e cila gjendet në fund të parkut) ishte një ceremoni dekorimeve.

Nga ana tjetër, kur flasim rreth aktivizimit të rinjëve në Serbi në lidhje me çështjet e drejtësisë tranzicionale është e rëndësishme të theksohet se shumica ndjekin mesazhe politike që vijnë nga udhëheqja e partisë dhe konsistojnë në mohimin dhe mospranimin e krimeve që ndodhën gjatë vitit 1990.

Element i rëndësishëm gjatë analizës së këtij aksioni paraqet një element të personalitetit të Presidentit të Serbisë dhe veprimeve të tij. Së fundi, duke parë rezultatin e aksionit vijmë në përfundim se lëvizjet aktiviste dhe të rinjëve që ishin aktiv në sektorin e OJQ-ve kanë liri më të madhe në artikullimin e kërkesave të tyre, ndërsa mesazhi transmetohet nga të rinjtë e partive politike fokusuar në veprimin konkret politik me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe cilësisë së jetës.

Arsimimi

Domosdoshmëria e ekzistencës të arsimit bazuar në faktet

ndoshta më së miri na ilustron shembulli i ish-Jugosllavisë dhe arsyeja e shpërbërjes së saj. “Nëse diçka mund të mësohet nga Jugosllavia, atëherë është ajo se sa është katastrofike të gënjejehet për të kaluarën.²⁴ Deri në çfarë mase Jugosllavia në fakt ka dështuar për shkak se 45 vjet gënjen në mënyrë sistematike për të kaluarën e saj “Rëndësinë e arsimit të njohin të rinjtë, duke pranuar se ata nuk mund të marrin arsimimin e duhur në lidhje me këto ngjarje gjatë arsimit të rregullt për shkak të: narativave të përshtatura në tekstet shkollore të historisë, fakteve selektive të lartë përmendura, duke shfaqur popullin e tij si viktimë ekskluzive dhe në fund vullneti i mësuesit për të folur për atë në klasë.

Prandaj, të rinjëve në Serbi i mbet që me arsim jo-formal të fitojnë bazat e drejtësisë tranzicionale dhe të njohin me fakte gjyqësore të vërtetuara në lidhje me shkeljet masive të të drejtave të njeriut në ish-Jugosllavi për të krijuar bazën e nevojshme të njohurive për aktivitete të tjera me të cilat merret: aktivizimin, përkujtimet dhe nismat rajonale. Edukimi rreth drejtësisë tranzicionale sot është në dispozicion në shumë shkolla të organizuara nga organizatat joqeveritare që kanë në fokus drejtësinë tranzicionale. Megjithatë, këto aktivitete, pasi që ato janë mënyra jashtë institucionale e arsimit, kanë mundësi për të përfshirë një numër relativisht të vogël të rinj.

Vizita profesionale/studimore përfaqësojnë një aspekt tjetër të arsimit që i mundëson të rinjëve që në praktikë të takohen me punën e institucioneve që zbatojnë mekanizmat e drejtësisë tranzicionale. Përvojat e të rinjëve që morën pjesë në këtë lloj të arsimit flasin në favor të rëndësisë së tyre praktike për të kuptuar bazën e funksionimit të drejtësisë tranzicionale.

Përkujtimet

Përkujtimet e viktimave dhe komemorimet si një formë e dëmshpërblimeve simbolike mbahen në mënyrë për të nderuar viktimat dhe shprehur solidaritetin, por edhe për ndërtimin e kujtesës kolektive të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut të së kaluarës. Përkujtimet janë një gjest i

22 Shih portalin online www.blic.rs 15.02.2015. Titulli: “Nikoliq kërcënon prokurorin: Kujdes se çka gërmon” (qasur më 16.07.2015).

23 Shih portalin online www.slobdnaevropa.org 15.02.2015 nën titullin: “Protesta e Nismës së të rinjëve: hetim, jo medalje” (qasur më 16.07.2015).

24 Ligjerata e Zharko Puhovski me titull “Çfarë ke bërë në luftë, baba?”, Botuar më 16.04.2012. në portalin www.byka.com (qasur më 16.07.2015).

rëndësishëm që shpreh qëndrimin gjykues ndaj krimit dhe dërgon një mesazh dhembshurie për viktimat dhe familjet e tyre. Një, në fakt, paraqesin “një parakusht të sanimit të pasojave të luftërave dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut pasi ato paraqesin një mënyrë të pranueshme për ndërtimin dhe rivendosjen e besimit të viktimave në institucionet e sistemit”²⁵

Raporti për përkujtimet në Serbi si dhe në vendet e tjera të rajonit, është themeluar në bazë të origjinës kombëtare të viktimave. Pranueshmëria për mbajtjen e përkujtimeve të viktimave të tyre dhe indinjatën gjatë përkujtimit e “të tjerëve” është një model i pranuar i sjelljes kur mbahen ngjarje të tilla. Kur flasim për përkujtimet, si një nga funksionet e tyre mund të merret se ato janë një mjet për krijimin e një grupi të përzgjedhur të njohurive në lidhje me të kaluarën. Për këtë pjesë do të marrë dy shembuj që janë paradigmatic në kontekstin e pasojave që janë prodhuar - përvjetorin e njëzetë të masakrës Tuzlës në Tuzla dhe përvjetorin e njëzetë të gjenocidit në Srebrenicë, të cilat janë shënuar në Beograd.

Veprimi i parë nën emrin “Dita e të rinjëve të vrarë” është organizua për të përkujtuar masakrën në portën e Tuzlës i cili me 25 Maj të vitit 1995 cilin e kreu ushtria e Republikës së Serbe në mënyrë që të pozicionohet në malin Ozren është gjuajtur predha që ra në sheshin kryesor apo vend takimi i të rinjëve dhe me këtë rast, duke vrarë 71 person ku moshë mesatare ishte 24 vjeç. Me atë rast, Nisma Ime organizoi aksionin e shkresës në Librin e ngushëllimit e cila për shtatë ditë u ngrit në disa vende në qendër të Beogradit, Novi Sad,

Nish dhe Novi Pazar, me qëllim që materialin e mbledhur të ia dorëzonin kryetarit të Tuzlës në ditën e përkujtimit.²⁶ Ky aksion shkaktoi reagime armiqësore nga mbështetja dhe inkurajimi i të rinjëve për të vazhduar me aktivitete të tilla, ndërsa nga ana tjetër ka pasur një sulm fizik në aktivistët e Nisma Ime gjatë regjistrimit në Librin e ngushëllimit në Sheshin e Republikës në Beograd.²⁷

Një tjetër aksion i quajtur “7000” kishte me qenë një nga konferencat më të mëdha të paqes në Serbi si përkujtimi i madh kolektive në Serbi në lidhje me një krim të kryer gjatë luftërave në ish-Jugosllavi. Ideja për aksion erdhi në twitter nga gazetari Dushan Masić i cili propozoi që 7000 njerëz të shtrihen para Kuvendit popullor të Serbisë më 11 korrik për të përkujtuar viktimat e gjenocidit të Srebrenicës, që në këtë mënyrë të rritet vetëdijesimi për krimet masive të kryera nga Ushtria e Republikës e Serbisë në korrik të vitit 1995. Situata rreth aksionit arriti kulmin në fillim të korrikut, kur një grup prej 10 organizata joqeveritare nga Beogradi e mbështeten aksionin civil # 7000,²⁸ ndërsa në të njëjtën kohë opstrukcionin e aksionin e njoftuan shumë organizata të krahut të djathtë, të udhëhequr nga Dveret dhe Partia Radikale Serbe. Vetë tubimi pranë Kuvendit popullor ka një peshë të fortë simbolike pasi që ajo përfaqëson një degë të qeverisë, ndërsa, 20 vitet e fundit platoja para Kuvendit tradicionalisht është përdorur për tubime më të larta politike. Ministri i policisë një ditë para përkujtimeve së planifikuar ndaloi të gjitha tubimet për 11 korrik,²⁹ kështu që tubimi i qytetarëve ndodhi para ndërtesës së Presidencës së Serbisë simbolikisht në ora 11:07 në mbrëmje.³⁰ Me atë rast janë mbledhur rreth 500 persona të cilët i kanë ndezur

25 Goran Zoriq, “Prijedor: Reparacionet simbolike”, Punimet e Shkollës Rajonale të drejtësisë tranzicionale, të Fondit për të Drejtën Humanitare, Beograd, 2014, f. 89th.

26 Më shumë për dorëzimin e Librit të ngushëllimit shih në: <http://novi.ba/clanak/19433/kapija-aktivisti-iz-srbije-tuzlacima-urucili-knjiguzalosti> (qasur me 17.07.2015).

27 Më shumë rreth sulmit në Aktivistët e Nisma Ime shihni në www.youtube.com video me titull: “Aktivistët e aksioneve serbe grisnin Librin e “ngushëllimit” “Gratë në të zeza”; në dispozicion në <https://www.youtube.com/watch?v=KtZ162djwFA> (qasur më 17.07.2015).

28 Shih artikullin e botuar me 07.02.2015 Në portalin www.crnp.rs me titull: “Organizatet e shoqërisë civile mbështeten aksionin shtatë mijë”; në dispozicion në <http://www.crnp.org.rs/2015/organizacije-civilnog-drustva-podrzale-akciju-sedam-hiljada> (qasur më 17.07.2015).

29 Shih tekstin e publikuar me 10.07.2015 në portalin www.b92.net me titull: “Policia ndaloi të gjitha tubimet”; në dispozicion në http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=07&dd=10&nav_category=11&nav_id=1014026 (qasur më 17.07.2015).

30 Shih artikullin e botuar me 11.07.2015 në portalin www.n1info.com titulluar “Qirinj për Srebrenicën: aksioni #shtatë mijë tek Presidencën”; (qasur më 17.07.2015).

qirinj dhe në trotuar kanë ngjitur letra në të cilat ishin shkruar numrat nga 1 deri në 7000. Në të njëjtën kohë, në anën tjetër të parkut ishin anëtarët e organizatave të djathtës të udhëhequr nga lideri i Partisë Radikale Serbe, Vojislav Sheshelj duke brohoritur emrin e Ratko Mlladiçit dhe kënduar këngë nacionaliste.

Një aspekt i rëndësishëm i këtij përkujtimi është mënyra raportimit të mediave serbe mbi to, madje edhe reagimet kundërshtuese të mediave të ndryshme, duke zbuluar një foto të një shoqëri të ndarë thellësisht në Serbi, shoqërisë që mbart një barrë të madhe të së kaluarës nga e cila nuk është ende në gjendje për tu liruar nga ajo. Pyetja që shtrohet në diskursin publik: a është shoqëria vetëm një viktimë apo një pjesëmarrësit në ngjarjet që u shënuan në vitin 1990.

Nismat rajonale

Organizatave e shoqërisë civile nga ish-Jugosllavia të motivuara nga nevoja për të adresuar nevojat e viktimave në mënyrë adekuate si dhe që viktimat janë në fokus të mekanizmave të drejtësisë tranzicionale, në vitin 2008 e themeluan Koalicionin, i cili avokon themelimin e Komisionit Rajonal për vërtetimin e fakteve (në tekstin e mëtejshëm KOMRA). Madje, gjatë hartimit të saj konceptual është vendosur që mandati i këtij komisioni duhet të jetë verifikimi e fakteve për shkeljet masive të të drejtave të njeriut në ish-Jugosllavi ne periudhën prej viteve 1991 dhe në vitin 2001.

“Sipas draft Statutit, KOMRA është një komision ndërqeveritar i përberë nga shtetet e ish-Jugosllavisë. Ky organ jashtëgjyqësor do të hetojë të gjitha akuzat për krime të luftës dhe shkeljeve tjera të të drejtave të rënda të njeriut në lidhje me luftën do të regjistron të gjitha viktimat e luftës dhe viktimat e krimeve të lidhura me luftën; do të mbledhë informacion në lidhje me kampet dhe vende të tjera të mbylljes së detyruar. Komisioni rajonal do të jetë i pavarur nga themeluesit e saj.”³¹

Gjatë viteve, nga ideja initiale deri tek hartimi i saktë të Statutit e KOMRA-s janë mbajtur një sërë takimesh konsultative dhe tryeza të rrumbullakëta cilat kanë mbledhur intelektualë të shquar, aktivistë të të drejtave të njeriut, përfaqësues të viktimave, veteranët, të burgosurit, artistët, avokatët por i mblodhi dhe një numër të rëndësishëm i të rinjëve nga rajoni.

Në vitin 2011 u realizua një nga aksionet më të mëdha në Ballkanin Perëndimor, kur u sinkronizua aksioni në shtatë vendet e ish-Jugosllavisë dhe janë mbledhur mbi gjysmë milioni nënshkrime të qytetarëve nga rajoni për të mbështetur themelimin e KOMRA-s.³² Në fushatë për të mbledhur nënshkrime ishin përfshirë aktivist/aktivistët e rinj të drejtave të njeriut nga rajoni cilët kanë mbledhur nënshkrime për disa muaj në dhjetëra qytete, duke iu shpjeguar nënshkruesve për rëndësinë e krijimit të një komisioni të tillë.

Roli i të rinjëve në avokimin e KOMRA-s kishte për qëllim për të krijuar një front të gjerë shoqëror i cili mbështet krijimin e një komisioni në nivel rajonal. Kjo, për më tepër, i kishte dhënë edhe një lloj legjitimiteti të Nismës për KOMRA, sepse një nga objektivat e Komisionit dhe “kontributi në parandalimin e përsëritjes së krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të drejtave të njeriut,”³³ ku do të jenë përfituesit konkretisht njerëz të rinj nga vendet e ish-Jugosllavisë, si bartës procesi të pajtimit në të ardhmen.

Përfundim

Shqyrtimi i qasjeve metodologjike ndaj aktivizimit të rinjëve në fushën e drejtësisë tranzicionale na mundëson një pasqyrë në diversitetin dhe shtrirjen e angazhimit të tyre. Në kuadër të temave që janë paraprakisht të dhëna, të rinjtë janë duke u përpjekur për të ofruar një qasje inventivë përmes metodave të ndryshme ndërdisiplinore. Vlera e tyre e veçantë është komponenti rajonal që në fakt, paraqet pikën e fillimit nga e cila i shikojnë ngjarjet e kaluarës. Përgjegjësia që qëndron mbi të rinjtë është se aktivitetet e tyre janë qartësisht të distancuara nga politika që çoi në luftëra dhe

31 Në dispozicion në: <http://www.recom.link/sr/o-nama-sr/sta-je-rekom/> (qasur me 17.07.2015).

32 Shih artikullin e botuar më 26.04.2011. Në www.blic.rs Portali me titull “Iniciativa për themelimin e KOMRA-s në ish-Jugosllavi”; në dispozicion në <http://www.blic.rs/Vesti/Politika/250532/Inicijativa-za-osnivanje-REKOMA-na-prostoru-bivse-SREJ> (qasur me 17.07.2015).

33 Neni 13 i Projekt propozimit të Statutit të KOMRA-s përmban qëllimet e KOMRA-s. Teksti i plotë i Statutit është në dispozicion në: <http://www.recom.link/wp-content/uploads/2014/11/SR-Izmene-Statuta-FINAL-12.11.2014-ff.pdf> (qasur me 17.07.2015).

shkaktoi shkeljet masive të të drejtave të njeriut në vendet ku ata janë në zhvillim të sotëm duke mbajtur barrën e të kaluarës së luftës.

Kuadri joinstitucional ka anën e saj pozitive në formën e lirisë së plotë që të rinjtë e kanë gjatë zgjedhjes së çështjes që do të trajtojnë dhe metodat cilat do ti përdorin. Nga ana tjetër, pengohen në realizimin e aktiviteteve të tyre për të arritur kontekstin më të gjerë shoqëror, sepse për shkak të mungesës së kapaciteteve institucionale dhe mbështetjes së shtetit, këto nisma arrin vetëm deri tek relativisht rrethi i ngushtë të njerëzve.

Së fundi, nevoja për tu ballafaquar me të kaluarën dhe krimet e luftës të cilat kanë ndodhur në të kaluarën e afërt kanë rendësi esenciale për procesin e pajtimit në ish-Jugosllavi. Roli i të rinjëve është edhe më i rëndësishëm, sepse ata janë një nga iniciatorët dhe promovues të proceseve shoqërore dhe nxitësit në zbatimin e mekanizmave të drejtësisë tranzicionale. Të rinjtë kanë të drejtë për ta ditur se çfarë ka ndodhur, për ti kuptuar proceset që kanë çuar deri tek aty, të ballafaqohen me të dhe duke absorbuar faktet vendosin paqe dhe bashkëpunim të qëndrueshëm në vendet e ish-Jugosllavie, që do të bëhen garantues një paqeje stabile dhe të qëndrueshme në këtë rajon.

Cilat janë pasojat e imunitetit të KB-ve në ruajtjen e të drejtave themelore të njeriut?

Adisa Fišić

1. Hyrje

Qëllimi themelor i misionit paqësor të KB-ve është vendosja e sërishme e paqes dhe e sigurisë ndërkombëtare e, megjithëkëtë, niveli joadekuat i përgjegjësive dhe i mosndëshkimit e rrezikojnë integritetin dhe vlerat themelore të këtyre misioneve. Sipas Konventës mbi privilegjet dhe imunitetin e Kombeve të Bashkuara, KB-të kanë imunitet në çfarëdo procedure juridike, gjë që në praktikë do të thotë ndalim i pjesëmarrjes së organeve gjyqësore të cilitdo shtet.

Sipas të drejtës ndërkombëtare, shkelja e të drejtave të njeriut përbënë shkak për KB-të për të vendosur misionet e veta paqësore.³⁴ Në këtë punim shfrytëzohet morali si disiplinë ndihmëse, në mënyrë ë të merremi me çështjen: a konsiderohen KB-të përgjegjëse për shkeljen e të drejtave të njeriut gjatë misioneve paqësore? Teoria morale do të sigurojë të dhënat e domosdoshme për analizimin nëse KB-të e shfrytëzojnë imunitetin si mbrojtje në këto situata. Problemi paraqitet në lidhje me çështjen nëse imuniteti mund të hiqet ose është absolut dhe, së këndejmi, për këtë punë hulumtuese shfrytëzohet studimi i rastit *Nënat e Srebrenicës*.³⁵

Pjesa e parë e këtij punimi përqendrohet në kontekstin juridik të KB-ve, si dhe në burimet dhe në natyrën e imunitetit. Nëpërmes të rastit *Nënat e Srebrenicës* prezantohen dy qasje të mundshme lidhur me çështjen e imunitetit. Gjykata e Apelit holandeze ka arritur deri te konkluzioni se imuniteti, në rrethana të caktuara, mund të hiqet, por Gjykata Supreme holandeze me një qëndrim shumë të qartë e ka konfirmuar imunitetin absolut të KB-ve. Situata në terren tregon se kjo çështje ende është një çështje kontroverse. Sekretari i përgjithshëm i KB-ve, Ban Ki-Moon gjatë vizitës së Qendrës Memoriale të Srebrenicës ka deklaruar se „bashkësia ndërkombëtare nuk ia ka dalë për të siguruar mbrojtjen e nevojshme për shumë njerëz, të cilët janë vrarë në kohën kur përkrahja jonë ka qenë e nevojshme për ta”.³⁶ Po ashtu, do të shqyrtohet edhe çështja nëse ekziston hierarkia midis imunitetit dhe normave *ius cogens*.

Pjesa e dytë e këtij punimi fokusohet në analizën e përgjegjësive institucionale morale, në pushtetin dhe në përgjegjësinë morale. Pjesa e parë e teorisë së moralit janë bazat teorike mbi përgjegjësinë institucionale morale. Më tej, analiza e pushtetit dhe e përgjegjësive e qartëson se vërtetimi

34 Këshilli i Sigurimit gjithnjë e më shumë e konsideron shkeljen e të drejtave të njeriut arsye për intervenim dhe kjo është vënë në spikamë në rezolutat e Këshillit të Sigurimit. Somalia 794(1992), Ruanda 929(1994), Haiti 1529(2004).

35 *Shoqata Nënat e Srebrenicës kundër Holandës dhe Kombeve të Bashkuara*, 10/04437 EV/AS (Gjykata Supreme, 2012).

36 Në datën 26 korrik të vitit 2012, Sekretari i Përgjithshëm, me rastin e vizitës së Srebrenicës, po ashtu i ka bërë thirrje botës që të nxjerrë porosi nga gjenocidi srebrenicas dhe ta ndërpres konfliktin, i cili është duke ndodhur në Siri.

i përdorimit të pushtetit nga ana e organizatës në të njëjtën kohë do të thotë edhe atribuim ose përshkrim i përgjegjësisë morale për të njëjtën.³⁷

Tema kryesore e këtij punimi është si në vijim: cilat janë pasojat e imunitetit të KB-ve në ruajtjen e të drejtave themelore të njeriut?

2. Imuniteti i KB-ve

KB-ve i është miratuar imuniteti me anë të nenit 105 të Kartës së KB-ve,³⁸ e cila është shfrytëzuar si bazë për miratimin e Konventës për privilegjet dhe imunitetin e Kombeve të Bashkuara (Konventa). Sipas kësaj Konvente, KB-të kanë imunitet në çfarëdo procedure juridike, gjë që në praktikë do të thotë ndalim i pjesëmarrjes së organeve vendore të gjyqësorit. KB-të dhe organet e tij ndihmëse kanë një „imunitet absolut“ shumë të gjerë, i cili është „i domosdoshëm për përmbushjen e objektivave të KB-ve“, siç thuhet në Preambulën e Konventës.

Neni VIII, paragrafi 29 i Konventës deri diku e kufizon vëllimin e imunitetit të KB-ve në atë mënyrë që i përcakton mekanizmat alternativ për zgjidhjen e kontesteve. Megjithatë, mekanizmat alternativ të zgjidhjes së kontesteve mund të vendosen vetëm në rastet kur Sekretari i Përgjithshëm nuk e heq imunitetin.³⁹

2.1. Analiza e rastit *Nënat e Srebrenicës*

Çështja themelore, e cila shqyrtohet në rastin *Nënat e Srebrenicës* është imuniteti i KB-ve si dhe nëse ai mund t'i shtrohet kufizimeve në juridiksionin e gjykatës kombëtare në Holandë. Ky rast po ashtu mund të tregojë se si nivelet e ndryshme të gjyqësorit holandez e kanë analizuar imunitetin e KB-ve.

Gjykata e shkallës së parë (Gjykata holandeze e Qarkut) ka konsideruar se nuk është kompetente në këtë rast, sepse KB-të i referohen imunitetit, kurse sipas nenit 105 të Kartës së KV-ve, ashtu siç në mënyrë të hollësishme është cekur në Nenin II, paragrafi 2 i Konventës, gjykatat vendore kombëtare nuk mund ta kufizojnë imunitetin e KB-ve. Çështja tjetër e analizuar në aktgjykim është pohimi se, pa revizion gjyqësor, e drejta në gjykim të drejtë⁴⁰ do të shkelej në mënyrë të drejtpërdrejtë, sepse mekanizmi alternativ, i paraparë dhe i përkufizuar në Paragrafin 29 të Konventës, nuk ka qenë i krijuar. Sipas rastit *Waite i Kennedy*⁴¹, e drejta në qasje ndaj gjykatës nuk është absolute dhe mund të jetë e kufizuar me imunitetin, nëse kufizimi është proporcional me qëllimin legjitim⁴², e po ashtu edhe e drejta në qasje ndaj gjykatës nuk është e zvogëluar në rastin kur ankuesit kanë pasur në dispozicion një alternativë të arsyeshme.⁴³ Gjykata ka arritur në konkluzionin se ky i ashtuquajtur *Kennedy test* nuk është i zbatueshëm në KB-të, sepse është krijuar me anë të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (ECHR), kurse anëtarësia universale i dallon KB-të nga organizatat rajonale me anëtarësi të kufizuar.

37 Lukes, S. (2005) *Pushteti: Shikimi radikal (Power: A Radical View)* (botimi i dytë i reviduar), New York: Palgrave Macmillan.

38 Neni 105 i Kartës së KB-ve: „Organizata do të ketë në territorin e secilit shtet të vet anëtarë privilegje dhe imunitet të tillë, të cilat janë të nevojshme për plotësimin e qëllimeve të organizatës.“

39 Konventa, me anë të nenit V, paragrafët 20 dhe 23, e përcakton se Sekretari i Përgjithshëm mund ta heq imunitetin në secilin rast individual dhe se ai ka „të drejtën dhe obligimin për ta hequr imunitetin e cilitdo shërbyes ose zyrtar në rastin kur, sipas mendimit të tij, imuniteti e ka penguar rrjedhën e drejtësisë“.

40 E drejta në gjykim të drejtë është e përkufizuar dhe e mbrojtur me marrëveshjet ndërkombëtare, me Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Qytetare dhe Politike (neni 14) dhe me Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Në rastin *Waite i Kennedy*, parag. 50, Gjykata ka vendosur që „Neni 6 i Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut e mishëron 'të drejtën në gjykim', me fjalë të tjera, të drejtën në qasje ndaj gjykatës ose të drejtën e ngritjes së procedurës para gjykatave ...“

41 *Waite i Kennedy kundër Gjermanisë*, nr. 26083/94, 18 shkurt 1999.

42 *Ibid*, parag. 59: „...kufizimi nuk do të jetë në përputhje me nenin 6 § 1 nëse nuk e ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ekziston raporti i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimeve, të cilat dëshirohen të arrihen.“

43 KB-të, në pajtim me Paragrafin 29 të Konventës, janë të obliguara për të siguruar mekanizma alternativ në zgjidhjen e kontesteve, me anë të të cilave do të zgjidheshin kontestet e krijuara si pasojë e veprimtimit të KB-ve, por ky kusht nuk është plotësuar.

Gjykata e Apelit e ka mbështetur vendimin e Gjykatës së Qarkut, por me një arsyetim tjetër. Është cekur se imuniteti në kuadër të Nenit II, paragrafi 2 i Konventës „në mënyrë të pakontestueshme përkufizohet si më i gjeri i mundshëm“, kurse në lidhje me Nenin 105 të Kartës së KB-ve imuniteti i KB-ve karakterizohet si imuniteti me ndikimin më të gjerë.⁴⁴ Një dallim i rëndësishëm në raport me vendimin e Gjykatës së Qarkut është ai se Gjykata e Apelit e ka përcjellë arsyetimin e shpjeguar paraparak të rastit *Waite i Kennedy*, dhe e ka refuzuar konstatimin e Gjykatës së Qarkut se vendimi i *Waite i Kennedy* është sjellë në bazë të asaj nëse një organizatë e caktuar ka ekzistuar para miratimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse ka qenë e “pabesueshme që vendimi implikon se fakti se ekziston një organizatë ndërkombëtare më gjatë se sa Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut paraqet arsye të mjaftueshme për qëndrimin se nënshkruesit janë të liruar nga obligimi i tyre për të garantuar të drejtat themelore të garantuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”⁴⁵

Më tutje, Gjykata e Apelit e ka vënë në spikamë se paditësit e kanë pasur mundësinë për të paditur kryerësit dhe shtetet dhe për këtë arsye qasja e gjykatës nuk ka qenë e mohuar.⁴⁶

Çështja tjetër, të cilën e ka shqyrtuar gjykata ka qenë nëse neni 103 i Kartës së KB-ve në lidhje me hulumtimin e imunitetit të KB-ve është në përputhje me Nenin 6 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut ose me Nenin 14 të Paktit Ndërkombëtar mbi të drejtat qytetare dhe politike.

Gjykata e Apelit ka arritur në konkluzionin se qëllimi i Nenit 103 nuk është që të ndajë të drejtat themelore të garantuara me të drejtën zakonore ose me marrëveshje ndërkombëtare. Në Preambulë të Kartës së KB-ve thuhet se qëllim i KB-ve është promovimi i lirive themelore dhe i të drejtave të

njeriut dhe do të ishte kontradiktore që neni 103 të shkel zbatimin e atyre të drejtave.⁴⁷

Gjykata e Apelit e ka refuzuar pretendimin e paditësit se gjenocidi në Srebrenicë ka qenë krim aq i rëndë sa që mossauesi i KB-ve për ta parandaluar do të duhej të çonte deri te heqja e imunitetit të tij, sepse pretendimi i tillë do të shpinte deri te rreziku i keqpërdorimit të gjykatave vendore anë e kënd botës në lidhje me çështjet të cilat kanë të bëjnë me misionet paqësore, krahas vërejtjes se „megjithëse KB-të nuk kanë kryer krime kundër njerëzimit, ato nuk kanë reaguar në mënyrë adekuate ndaj krimeve.“⁴⁸ Konkluzioni i Gjykatës së Apelit në lidhje me imunitetin është si më poshtë: „Imuniteti nga ndjekja penale, që është miratuar për KB-të, së këndejmi është ngushtësisht i lidhur me interesin e përgjithshëm, i cili ka të bëjë me ruajtjen e paqes dhe të sigurisë në botë. Nga kjo arsye, është shumë e rëndësishme që KB-të ta kenë imunitetin më të gjerë të mundshëm, duke lejuar sa më pak diskutim për të njëjtin.“⁴⁹

Gjykata Supreme e ka konfirmuar qëndrimin mbi ekzistimin e imunitetit absolut të KB-ve, kurse padinë e paditësit me kërkesën për heqjen e imunitetit të KB-ve me qëllim që të sigurohet e drejta për gjykim të drejtë në përputhje me nenin 6b të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka refuzuar. Gjykata Supreme ka arritur në konkluzionin se Gjykata e Apelit gabimisht është mbështetur në kriteret e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Waite i Kennedy* që të mund të vlerësonte nëse do të duhej të hiqej imuniteti i KB-ve për shkak të së drejtës në gjykim të drejtë. Gjykata Supreme ka konsideruar se imuniteti i KB-ve është absolut dhe se obligimet nga Karta e KB-ve do të duhej ta kishin primatin ndaj obligimeve, të cilat rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, në pajtim me nenin 103 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Në pajtim me këtë, Gjykata Supreme ka marrë parasysh

44 Gjykata e Apelit e ka analizuar Nenin II, paragrafin 2 të Konventës në dritën e Nenit 31 të Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Marrëveshjeve Ndërkombëtare, sipas të cilës marrëveshja duhet të interpretohet në përputhje me kuptimin e zakonshëm në lidhje me lëndën e marrëveshjes dhe me qëllimin.

45 Ankesa ndaj aktgjykimit në rastin *Nënat e Srebrenicës*, parag. 5.4.

46 *Ibid*, parag. 5.11.

47 *Ibid*, parag. 5.5.

48 *Ibid*, parag. 5.10.

49 *Ankesa ndaj aktgjykimit në rastin Nënat e Srebrenicës*, par. 5.7.

aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Behrami*⁵⁰, ku gjykata e ka konfirmuar se kundërshtimet janë të papranueshme, sepse nuk kanë ekzistuar kompetencat *ratione personae* për shqyrtimin e faktit nëse aksionet e pranisë ndërkombëtare janë kompaktibile me dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata po ashtu i është referuar aktgjykimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në lidhje me çështjen e konfliktit të imunitetit dhe normave *ius cogens*, për çka flitet në pjesën në vijim.

2.2. Imuniteti dhe shkelja e normave *ius cogens*

Çështja nëse hierarkia midis imunitetit dhe normave *ius cogens* është relevante ka qenë në dhjetëvjetëshat e fundit temë e diskutimeve midis ekspertëve si dhe ka qenë lëndë e hulumtimit në gjykatat ndërkombëtare dhe vendore. Rasti, i cili më shpeshti ceket kur shtrohet kjo çështje është rasti *Gjermania kundër Italisë*⁵¹ para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në lidhje me aktgjykimin e Gjykatës Supreme italiane, e cila ka konfirmuar se Gjermania nuk ka të drejtë në imunitetin gjyqësor para gjykatave italiane, sepse paditësi ka kërkuar zhdëmtimin për shkeljen e normave imperative të së drejtës ndërkombëtare.

GjND ka arritur në konkluzionin se rregullat *ius cogens* i nxjerrin jashtë fuqisë rregullat mbi imunitetin ose, me fjalë të tjera, „Nuk ka konflikt midis atyre rregullave dhe rregullave mbi imunitetin shtetëror. Këto dy grupe të të drejtave kanë të bëjnë me gjëra të ndryshme. Rregullat mbi imunitetin e shtetit janë të karakterit procedural dhe janë të kufizuara në vërtetimin nëse munden ose jo gjykatat e një shteti për të pasur kompetenca në raport me shtetet e tjera. Rregullat

nuk kanë të bëjnë me çështjen nëse sjellja, për të cilën është nisur procedura, është e ligjshme ose e paligjshme.“⁵²

3. Përgjegjësia institucionale morale

I. Përgjegjësia institucionale morale mbetet një zonë e pahulumtuar në fushën e të drejtës ndërkombëtare dhe kjo lehtë mund të shihet nëpërmjet hulumtimit të literaturës relevante. Realiteti është se në fushën e të drejtës ndërkombëtare, shtetet, si entitete të pranuar, edhe më tutje akterë qendror.

Me qëllim që individi të jetë moralisht përgjegjës për veprat e veta, „ai do të duhej të posedonte aftësinë për të medituar për çështjet morale dhe që të jetë i ndërgjegjshëm për sjelljet e veta në përputhje me kodekset e caktuara morale“.⁵³ Kushti i dytë është se sjellja konkrete është e motivuar me një qëllim të caktuar dhe me interesa si dhe që individi të veprojë lirisht.⁵⁴ Megjithëkëtë, nëse „kolektiv“ si organizatë ndërkombëtare posedon këto karakteristika, mund të konsiderohet moralisht përgjegjës për veprat e veta.⁵⁵

Me qëllim që të hapet çështja e përgjegjësisë institucionale morale në mënyrë specifike për KB-të, do t'i shfrytëzoh argumentet të cilat i ka pashtuar Toni Erskine. Sipas fjalëve të tij, që institucioni të kualifikohet si agjent, krahas kushteve të cilat janë përmendur më herët, një kusht shtesë është: „Një identitet, i cili është më shumë se përmbledhja e identiteteve të pjesëve të tij përbërëse dhe i cili, së këndejmi, nuk mbështetet në një anëtarësi të caktuar; struktura, e cila i sjellë vendimet; identiteti nëpër kohë; dhe koncepti i vetvetes si njësi.“⁵⁶

50 Rasti është ngritur kundër Francës në rastin e djaloshit, i cili ka pësuar me vdekje dhe për vëllamë e tij, i cili është lënduar në eksplozim të bombës, të cilën NATO-ja e ka hedhur në Kosovë. Prokurori ka vënë në spikamë se incidenti ka ndodhur, sepse forcat franceze në Kosovë nuk e kanë shënjuar bombën si të deaktivizuar, gjë që ka qenë detyrë e tyre. Ankesa është bazuar në nenin 2, i cili rregullon të drejtën në jetë sipas dispozitave të ECHR.

51 *Imuniteti gjyqësor i shtetit (Gjermania kundër Italisë)*, Aktgjykim, 3 shkurt i vitit 2012.

52 *Ibid*, parag. 93.

53 Erskine Toni (2004). *Gjaku në duart e KB-ve? (Blood on UN's Hands?) Atribuimi i obligimit dhe përcaktimi i fajit për organizatat ndërqeveritare*. Global Society, f. 26.

54 Harbour V. (2003) *Agjencia morale kolektiv dhe procesi politik (Collective Moral Agency and the Political Process)*.

55 Copp David (1991) *Përgjegjësia dhe mosveprimi kolektiv (Responsibility and Collective Inaction)*, Journal of Social Philosophy Volume 22, Issue 2, p. 71–80.

56 *Supra* n. 20, p. 24.

Kushti i parë kërkon që KB-të të posedojnë një identitet, i cili nuk është i kufizuar me identitetin e shteteve anëtare. Madje edhe nëse identiteti dhe subjektiviteti juridik nuk janë të njëjtë, fakti se KB-të e kanë subjektivitetin e vet vetjak juridik ndërkombëtar⁵⁷ është po ashtu relevant dhe implikon që KB-të kanë identitet të ndashëm prej shteteve të tyre anëtare dhe se, së këndejmi, veprimet e tij juridike kanë implikime morale.⁵⁸ Kushti i ekzistimit të identitetit nëpër kohë bëhet vetvetiu i qartë – organizata është themeluar pas luftës së Dytë Botërore me qëllimin kryesor parandalimin e konflikteve dhe promovimin e paqes dhe të sigurisë ndërkombëtare.

Struktura e sjelljes së vendimeve në KB qartë është e përkufizuar në Kapitullin V të Kartës së KB-së: kjo strukturë i bartë vendimet individuale të shteteve anëtare në aksionin e përbashkët institucional, gjë që është po ashtu vërtetim se bëhet fjalë për konceptin e KB-ve si njësi të veçantë.

3.1 Atribuimi i përgjegjësisë

Përgjegjësia morale nuk është njësoj si edhe përgjegjësia juridike. Mejthëkëtë, është e zakonshme që, kur një vepër e caktuar shkakton përgjegjësi morale, kjo me vete tërheq edhe përgjegjësinë juridike për atë vepër të kryer. Dy terme të tjerë, të cilët janë ngushtësisht të lidhura, janë „pushteti“ dhe „përgjegjësia: pushteti shpesh konsiderohet si kusht dhe si shkak i përgjegjësisë dhe rritja e pushtetit drejtpërdrejtë ndikon në rritjen e përgjegjësisë.⁵⁹

Steven Lukes e promovon analizën se identifikimi i përdorimit të pushtetit nga ana e organizatave në të njëjtën kohë është edhe atribuimi i përgjegjësisë dhe shton: “Me fjalë të tjera, poenta e locimit të pushtetit është që të caktojë përgjegjësinë për pasojat, të cilat do të rezultojnë nga aksioni ose mungesa e aksioneve të caktuara, agjentëve specifik.”⁶⁰ Ai, po ashtu e vë në spikamë se „të pushtetshëm janë ata për të arrijmë te përfundimi se janë të pushtetshëm

ose ata të cilët mund të konsiderohen përgjegjës për pasojat e rëndësishme”. Schaap po ashtu e përkrah mendimin se posedimi ose përdorimi i pushtetit shkaktojnë pasojat të drejtpërdrejta sa që agjenti do të jetë moralisht përgjegjës për veprimet e veta si edhe për pasojat e mundshme, të cilat ato veprime kanë mundur për t'i pasur për të tjerët.⁶¹

Kritikët e qasjes së Lukesit konsiderojnë se, sipas analizës së tij, kur nuk ka pushtet nuk mund të arrihet as tek atribuimi i pushtetit, sepse, sipas mendimit të tij, nëse një problem nuk krijohet me përdorimin e forcës, atëherë ai është prodhim i kufizimeve strukturale. Koncepti i përgjegjësisë politike është promovuar si kritikë e punës së Lukesit, sepse trajton çështje të cilat janë të përjashtuara nga analiza e tij. Kjo kërkon që “madje edhe nëse asnjë agjent ose agjenti, që mund të identifikohen, nuk mund të konsiderohet përgjegjës për krijimin e marrëdhënies së dhënë të dominimit, ata akterë, veprimet e të cilëve kanë ndihmuar që ai raport të prodhohet, janë të obliguar që të përpiqen për ta kuptuar dhe për ta ndryshuar.”⁶²

4. Përfundim

Imuniteti i KB-ve, i cili i është miratuar me Nenin 105 të Kartës së KB-ve, dhe Konventa mbi Privilegjet dhe Imunitetin e Kombeve të Bashkuara i japin kësaj organizate „privilegje dhe imunitete, të cilat janë të nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të organizatës“ dhe po ashtu e parandalon keqpërdorimin e gjykatave vendore në lidhje me pretendimet/kërkesat lidhur me misionet paqësore të KB-ve.

Në rastin *Nënat e Srebrenicës*, Gjykata Supreme holandeze konsideron se KB-të e kanë pasur imunitetin më të gjerë absolut dhe e ka refuzuar *Kennedy test-in*, i cili thotë se imunitet është i pranueshëm nëse është proporcional me qëllimin legjitim dhe nëse palët e interesuara kanë mekanizma alternativ të arsyeshëm. Gjykata Supreme e ka konfirmuar aktgjykimin e shkallës së dytë, por me

57 Subjektiviteti juridik i KB-ve është i konfirmuar nga ana e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në *Mendimin këshillëdhënës mbi reparacionet për shkeljet e shkaktuara në shërbim të Kombeve të Bashkuara (I.C.J. Reports 1949, pp. 174-188, at 179).*

58 Erskine, *supra* n. 24, p. 34.

59 Stahl B.C. (2004) *Përgjegjësia për sigurinë e informatave dhe privatësinë: problemi i etikës individuale? (Responsibility for Information Assurance and Privacy: A Problem of Individual Ethics?)* De Montfort University, UK, Volume 16, Issue 3, p. 19.

60 Lukes, S. (2005) *Pushteti: Shikimi radikal* (botimi i dytë i përmirësuar), New York: Palgrave Macmillan. p. 56.

61 Schaap, A. (2000). *Pushteti dhe përgjegjësia: a duhet ta kursejmë kokën e mbretit? (Power and responsibility: should we spare the king's head?)* Politics, 20(3), p. 129-135.

62 Hayward. C. (2006) *Mbi pushtetin dhe përgjegjësinë (On Power and Responsibility)*, Political Studies Review, vol. 4, p. 156-163.

një arsyetim tjetër, që po ashtu është i zbatueshëm në aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së parë (të Qarkut). Ky rast tregon se si të njëjtat aktgjykime mund të nxirren nga arsyetimi ndryshe dhe se si gjykatat i sjellin konkluzionet juridike në lidhje me vëllimin e imunitetit të KB-ve.

Përgjegjësia morale institucionale kërkon elemente shtesë, duke filluar prej atyre që kërkojnë që individi të konsiderohet moralisht i përgjegjshëm, kurse KB-të, si organizatë ndërkombëtare, t'i plotësojnë të gjitha kriteret, të cilat kërkohen. Qëllimi kryesor i KB-ve është promovimi i paqes dhe i sigurisë ndërkombëtare dhe, ashtu siç është

vënë në spikamë në preambulën e Kartës së KB-ve, KB-të promovojnë edhe të drejtat themelore të njeriut. Sipas teorisë së Lukesit, pushteti moral në mënyrë automatike e kërkon përgjegjësinë morale, kurse në kontekstin e KB-ve kjo do të thoshte për te përgjegjësi morale për shkeljet e kryera gjatë misioneve paqësore.

„Pushteti duhet të shndërrohet në autoritet, kurse kompetenca duhet të përkrahet nga ana e gjyqësorit.“

(Inis L. Claude, 1966.)

Marrëdhëniet konfliktuale dhe post-konfliktuale të Dubrovnikut dhe Trebinjës:

Analiza e marrëdhënieve të dy qyteteve fqinje në luftë dhe në paqe

Mirza Hebib

Në dritën e shpërbërjes së Jugosllavisë, kurse pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kroacisë në vitin 1991, Armata Popullore Jugosllave (APJ), me përkrahjen e Mbrotjtjes Territoriale të Malit të Zi, ka kryer sulm mbi Dubrovnikun. Rrethimi ushtarak nëntëmujor i Dubrovnikut, nga vjeshta e vitit 1991 e deri në pranverën e vitit 1992, ka pasur pasoja të paparashikueshme negative jo vetëm në Dubrovnikun dhe tërë rajonin dubrovnikas, por edhe në popullatën e hapësirave prej të cilave është kryer sulmi. Sulmet janë përkrahur me të vetmen mënyrë të parandalimit të „gjenocidit ustash“ mbi popullatën serbe në Kroacinë e pavarësuar, porse nga perspektiva e sotme mund të themi se si shtytja kryesore ka qenë nacionalizmi serbomadhi, i cili në vitet nëntëdhjetë ka qenë në kulmin e tij dhe i cili nuk e ka lejuar humbjen e Dubrovnikut, qoftë për arsye strategjike, ashtu edhe për ato ideologjike. Pas përfundimit të luftës, popullata e Dubrovnikut dhe e Trebinjës mbyllet në dy qytete, përndryshe 30 kilometra larg njëri tjetrit, dhe ndërpritet secili aspekt, do të mund të thoshim, i marrëdhënieve mijëvjeçare. Në punim analizohet sulmi në Dubrovnikun dhe jepet një pamje dhe një vështrim në gjendjen njëzet vite pas përfundimit të konfliktit.

1. Hyrje

Dubrovniku është qytet historik i vendosur në pjesën më të ngushtë të bregut kroat me një bërthamë historike të qytetit të ruajtur mirë të përfshirë në regjistrin e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Thelbin e qytetit e përbënë qyteza mesjetare me një sipërfaqe prej rreth 13,38 hektarësh

e rrethuar me mure e me fortifikata nga të gjitha anët. Qyteti është i pasur me monumente të jashtëzakonshme arkitektonike, duke përfshirë kishat, pllajtat dhe ndërtesa publike dhe, së këndejmi, konsiderohet si një nga fortifikimet më të bukura qytetare në Evropë.

Nga data 1 tetor e vitit 1991, Armata Popullore Jugosllave (APJ) dhe forcat malaziasë e kanë rrethuar qytetin dhe e kanë granatuar me qëllim të bashkëngitjes së qytetit dhe të zonave përreth të Malit të Zi fqinj.

Qysh nga viti 1971, kazerma e deriatëhershme e APJ-së në Dubrovnik ka qenë e boshatisur, kurse të vetmit ushtarë, të cilët mbeteshin në qytet kanë qenë marinarët e varkave të vogla të Marinës Detare Jugosllave, që kazermat e ishullit në Lastovë i kanë furnizuar me ushqim dhe me ujë. Në afërsi të Dubrovnikut, në vendin e quajtur Kupari, ka ekzistuar kompleksi i hoteleve në përbërje të institucionit ushtarak të Kuparit, me të cilin ka udhëhequr APJ, por ushtarët në shërbim në Kuparit kryesisht kanë qenë personel i shërbimit hotelier, derisa vet Institucioni ka qenë pothuajse e paarmatosur. Armatimi i tërësishëm i mbrotjtjes territoriale të Dubrovnikut ka qenë ruajtur në depot ushtarake në fshatin Duzhi afër Trebinjës, kurse rezervistët nga Dubrovniku në ushtrimet ushtarake kanë shkuar në poligonin ushtarak Grab mbi Trebinje ose në afërsi të vendit Ivanica, në komunën e atëhershme të Trebinjës. Komuna e Dubrovnikut dhe e Trebinjës deri në kohën e shpërbërjes së Jugosllavisë kanë qenë komunë kufitare, kurse vet qytetet janë të vendosura në largësi ajrore rreth 20 km përkatësisht 35 kilometra rrugë.

Në aspektin gjeostrategjik, komuna e Dubrovnikut është gjendur në një pozitë jashtëzakonisht të rëndë dhe mosmirënjohëse për organizimin e mbrojtjes së qytetit. Përndryshe, fqinjët tokësor, nga të gjitha anët, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi, pas pavarësimit të Kroacisë në vitin 1991 ende kanë qenë pjesë përbërëse të RSFJ-së dhe, së këndejmi, Dubrovniku fizikisht ka qenë i ndarë nga Kroacia. Sulmuesit nga hapësira e Trebinjës, po edhe nga Mali i Zi së shpejti do ta shfrytëzojnë një pozitë të këtyllë mosmirënjohëse dhe, së këndejmi, do ta shpëpusin plotësisht hapësirën e komunës së Dubrovnikut nga bota tjetër.

Në datën 25 prill të vitit 1991 është mbajtur referendumi në kuadër të të cilit qytetarët e RF të Kroacisë janë deklaruar se si nuk dëshirojnë të mbesin pjesë e RSFJ-së si dhe se dëshirojnë të jetojnë në shtetin e pavarur me mundësinë e hyrjes në aleanca me republikat e tjera. Në bazë të referendumit të cekur, në datën 25 qershor të vitit 1991, Kuvendi i Kroacisë e ka miratuar vendimin mbi sovranitetin dhe pavarësinë e Kroacisë. Të shtyrë nga frika për pozitën e popullit serb në Kroacinë e pavarur dhe, në të vërtetë, duke mos e dashur shpërbërjen e bashkësisë jugosllave si dhe duke iu referuar ngjarjeve të Luftës së Dytë Botërore dhe mundësisë së përsëritjes së gjenocidit ustash mbi popullatën serbe në Kroacinë e vetëvendosur, udhëheqja politike e serbëve dubrovnikas të asaj kohe e themelon degën e Partisë Demokratike Serbe (PDS) me qëllim të mbrojtjes dhe të mbijetesës së popullatës serbe në hapësirën e Dubrovnikut. Tubimi themelues dhe mitingu i përkrahjes është mbajtur në

vitin 1991 në vendin e quajtur Ivanica në prani të politikanëve serb të kreut të partisë. Në atë takim kanë qenë të pranishëm Radovan Karaxhiqi, Bozhidar Vuçureviqi, Jovan Rashkoviqi, Novak Kilibarda, Jovan Pejoviqi dhe shumë të tjerë. Në transkriptet e fjalimeve të asaj kohe qartazi është shprehur mundësia e operacioneve ushtarake, me anë të të cilave nga Dubrovniku do të krijohet Republika Dubrovnikase e re dhe e pavarur dhe e cila në një mënyrë do të ishte nën patronatin e Serbisë. Imponohet pyetja se përse, për çështje të këtylla, debaton një parti politike dhe a institucionalizohet si dhe a fshihet pikërisht në kuadër të partisë politike qëllimi i qartë për atë që do të pasojë. Në atë periudhë, në Mal të Zi, me përkrahjen e qeverisë, është zhvilluar fushata aktive e zjarrtë nën parullën „Luftë për paqe“ me anë të frikësimit të popullatës së atjeshme me informacione të rrejshme se përreth po tubohet ushtria kroate e përbërë prej „ustashëve“ dhe mercenarëve të jashtëm me qëllim të sulmit mbi Malin e Zi dhe të pushtimit të Bokës së Kotorrit.⁶³

2. Sulmi në Dubrovnik në vitin 1991

Në muajin shtator të vitit 1991 kanë filluar armiqësitë midis APJ-së dhe luftëtarëve kroat⁶⁴ në pjesën jugore të bregdetit kroat. Në datën 30 shtator të vitit 1991, në pajtim me Direktivën e Shtabit të Përgjithshëm të RSFJ-së, ish komandanti i Grupit Operativ 2 (GO), gjeneral-nënkoloneli Jevrem Cokiq, iu ka dhënë njësave vartëse urdhrin që të bllokojnë Dubrovnikun.⁶⁵ APJ ngadalë ka përparuar dhe i ka detyruar forcat kroate që të tërhiqen nga rrethina dubrovnikase.

63 J. Raguzh, Takimi themelues i PDS për Dubrovnik – Paralajmërimi i hapur i agresionit në zonën e Dubrovnikut, në Revistën për Historinë bashkëkohore, vit. 35, 1, Instituti Kroat për Histori, Zagreb, 2003., f. 35-41.

64 Në mbrojtjen e qytetit në fillim kanë marrë pjesë njësitë e vet-organizuar të paarmatosura, të cilat vetëm më vonë janë institucionalizuar. Në pajtim me terminologjinë e GJPNJ në punim shfrytëzohen nocionet e forcës kroate ose luftëtarët kroat. Sipas nenit 2 (1) të Ligjit mbi të drejtat e luftëtarëve kroat të Luftës Atdhetare dhe anëtarëve të familjeve të tyre „Luftëtarë kroat i luftës Atdhetare është personi i cili si vullnetarë dhe pjesëtarë i Forcave të Armatosura të Republikës së Kroacisë (ZNG, Ushtrisë Kroate, Ministrisë së Mbrojtjes, Policisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Forcave Mbrojtëse Kroate (FMK) si dhe pjesëtarë i forcave të armatosura dhe reparteve të Mbrojtjes Popullore, është personi i cili në to i ka kaluar së paku 5 muaj deri në datën 24 dhjetor të vitit 1991), dhe në mënyrë të organizuar ka marrë pjesë në mbrojtjen e pavarësisë, të tërësisë territoriale, përkatësisht të sovranitetit të Republikës së Kroacisë në cilëndo periudhë të Luftës Atdhetare.“

65 „Me pjesën më të madhe të forcave të kalohet në sulm me forcat kryesore në drejtimet: Ljubinja – Zavala – Slano; f. Ljubovo -Ivanica – Çibaçi dhe Grab – Dubravka – Molunat, kurse me forcat ndihmëse të sigurohen objektet dhe aerodromi në Mostar në luginën e Neretvës, me qëllimin që: me përkrahjen e tipit avio, me atë artillerike dhe të marinës me veprime të njëkohshme dhe energjike të shkatërrohen forcat në drejtimet e sulmit dhe të shpërthehet në brigje, të shkëputet magjistrallja e Adriatikut në shumë vende në sektorin Slano - Prevlaka, të bllokohet nga toka dhe nga deti Dubrovniku, aerodromi Çilipi dhe Prevlaka dhe të pamundësohet manovrimi i forcave të armikut e, pastaj, duke u siguruar nga drejtimi i vendit të quajtur Pllaka, të realizohet shkatërrimi dhe çarmatimi i forcave të rrethuara të armikut dhe të jetë në gjendje gatishmërie për veprimet e mëtejme të ofensivës në Hercegovinën Perëndimore.“ (Admirali Jokić, P. 4436-4437; Lëndë e provave nr. D44.)

Gjatë veprimeve të luftës në vitin 1991 në komunën e Dubrovnikut është granatuar qyteti. Shumë njerëz janë strehuar në hotelet dubrovnikase, në manastire në qytetin e Vjetër dhe në muzeun Rupe. Mbi qytetin janë kryer sulme nga ajri.⁶⁶ Ato sulme në fillim nuk kanë qenë të shpeshta, por gjatë granatimit janë bërë gjithnjë e më intensive. Është goditur trafostacioni në Lumin Dubrovniku kur edhe Dubrovniku ka mbetur pa rrymë elektrike dhe pa ujë.⁶⁷

Në fillim të muajit nëntor të vitit 1991 çeta mjeteve të blinduara e Brigadës së Motorizuar (Br. Mt) 3/472, në krye me kapitenin Neshiq e ka marrë urdhrin që të marrë pjesë në veprimet e luftës me qëllim të pushtimit të fshatit Bosanka dhe rrethinës. Në veprimet luftarake ka marrë pjesë edhe grupi i artilerisë bregdetare 107. Në atë operacion ka marrë pjesë edhe Mbrojtja Territoriale (MT) e Herceg Novit, si edhe Togu i Çetës së 3 3/472. i Br. Mt në krye me togerin Peshiq. Në periudhën nga muaji dhjetor i vitit 1991, midis palëve në konflikt ka ekzistuar një pabarazi e madhe në armatim. Forcat kroate ishin në numër shumë më të vogël, posaçërisht kur është fjala për artilerinë.⁶⁸

Blokada e Dubrovnikut nga APJ ka zgjatur disa javë gjatë të cilave APJ dukshëm ka përparuar në terren, me çka fuqishëm e ka shtrënguar rripin rreth Dubrovnikut. Megjithëkëtë, duhet të themi se si Dubrovniku ka qenë vetëm një nga çështjet e shumta kontestuese midis Beogradit dhe Zagrebit, por do theksuar edhe faktin se ka qenë në fuqi marrëveshja e Kroacisë dhe e Serbisë mbi ndërprerjen e pakusht të zjarrit

dhe tërheqjen e forcave të APJ-së nga Kroacia, që nuk janë zbatuar.⁶⁹ Trupi gjykues i GJPNJ⁷⁰ ka konstatuar disa herë në kuadër të aktgjykimit të Pavle Strugarit, ish gjeneralit të APJ-së, se si urdhërdhënësit e sulmit mbi Dubrovnikun janë gjendur në Trebinje.⁷¹

Në datën 5 dhjetor të vitit 1991 janë mbajtur negociatat dhe sipas dëshmisë së Jokiqit kanë qenë të zgjidhura të gjitha çështjet midis APJ-së dhe forcave kroate, pos mënyra e kryerjes së inspektimit të anijeve në det. Por, megjithëkëtë, sulmi më i vrazhdë ka pasuar në datën 6 dhjetor. Qëllimi për të kryer sulmin në datën 6 dhjetor është i dukshëm edhe në deklaratat sipas të cilave togeri Lemal në takimin në datën 5 dhjetor të vitit 1991 në Ivanicë ka kërkuar pajime për detyrën, duke përfshirë pancirin e xhaketës, eksplozivin plastik dhe granatat.⁷²

Trupi gjykues ka konstatuar se si vet sulmi ka filluar sipas urdhrave të Kovaçevićit në orët e hershme të datës 6 dhjetor të vitit 1991. Qëllim ka qenë pushtimi i kuotës dominuese topografike Sërgj menjëherë mbi Dubrovnik që do të përbente një goditje të rëndësishme psikologjike për qytetarët e Dubrovnikut. Kovaçevići nuk ka dhënë kurrfarë urdhrash në lidhje me nivelin, me të cilin duhej të kryheshin veprimet në atë zonë: *“Nuk ka pasur kufizime, vetëm le të ketë të shtëna.”*⁷³ Kovaçevići e ka pritur dorëzimin e luftëtarëve kroat në Sërgj, gjë që sigurisht do të përbente një hap të rëndësishëm në arritjen e qëllimit. Qyteti i Vjetër në mënyrë intensive është granatuar nga të gjitha anët.⁷⁴

66 Lucijana Peko, P. 1842.

67 Gjelo Jusiç, P. 1359-1360., Gjelo Jusiç, P. 1360.

68 Kapiteni Negodiç, P. 5355.

69 Marrëveshja e Gjenevës, 23 nëntor i vitit 1991. (UN Doc. S/23239. Annex).

70 TPNJ për shkurtësën për Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë në Den Haag.

71 Admirali Jokiç, P. 4039.

72 Nënkoloneli Stojanoviç, P. 7825. Të shikohet dëshmia e kapedanit Neshiq, P. 8167. Ai është gjendur në Zharkovicë dhe ka deklaruar se nënkoloneli Stojanoviç e ka ngritur një pjesë të pajimeve për ushtarët e tij në mbrëmjen e datës 5 dhjetor të vitit 1991.

73 Dëshmitari B, P. 5052; në lidhje me këtë edhe deklarata e kapedanit Negodiç, P. 5266-5267.

74 *„Granatat e para, të cilat kanë ushtuar ashtu afër, në të vërtetë, ne as që e kemi ditur se kanë rënë në Qytetin e Vjetër, sepse ne kemi punuar brenda, por të shtënat janë dëgjuar gjithnjë afër e më afër dhe, ashtu, myshterinjtë të cilët vinin në butik me tmerr flisnin se kanë filluar të gjuajnë me granata në Stradun, nëpër fontanë, nëpër ..., para kishës së të Shenjtit Vllaho. Kurse pastaj, më vonë, krejt kjo na është afëruar neve, afër e më afër dhe gjithnjë ka qenë e fortë e më e fortë. Kështu që unë, në një moment, kur kanë ndodhur sulmet më të forta, janë hedhur nga pesë-gjashhtë, ndoshta nga dhjetë granata në të njëjtën kohë nëpër të gjitha pjesët e qytetit, kështu që i gjithë qyteti ka qenë i sulmuar“* (Nikolla Joviç, P. 2934-2935.)

Përpos Qytetit të Vjetër, vrazhdësisht janë granatuar edhe pjesët veriperëndimore të Qytetit të Vjetër si dhe hotelet në veriperëndim dhe juglindje të Qytetit të Vjetër, në parim, të gjitha zonat e banimit. Sulmi në Dubrovnik pashmangshëm ka shkaktuar viktima në civilët. Dorëzimi i luftëtarëve kroat në Sërgj nuk ka ndodhur kurrë.

Në të njëjtën ditë, Colm Doyle, shefi i Misionit Vëzhgues Evropian është takuar me përfaqësuesit e APJ-së në shtabin e tyre në Trebinje, dhe, ashtu siç është shënuar më vonë në atë takim, Doyleut i është thënë se si veprimet luftarake në Dubrovnik janë përgjigje ndaj sulmeve në ushtarët serb në hapësirat e tjera në Bosnjë dhe Hercegovinë.⁷⁵

Pas trysnisë së bashkësisë ndërkombëtare, njësitë e APJ-së dhe të MT-së ngadalë janë tërhequr brenda territorit të Bosnjës dhe Hercegovinës, duke i pushtuar disa kuota të caktuara dominuese në afërsi të kufirit kroat. Duke i pushtuar kuotat e tilla, ato kanë ruajtur një përparësi të madhe ndaj luftëtarëve kroat dhe, së këndejmi, edhe kontrollin mbi Magjistralen e Adriatikut. Gjatë operacionit në Çagalj, në kuadër të të cilit është çliruar Fusha e Popit në B dhe H janë krijuar kushte për çlirimin e mëtejme të zonës së Dubrovnikut. Me operacionin Tigr i verën e vitit 1992 rezulton deri të çlirimi i pjesës së rrethinës dhe i Gurit të Golubit. Me operacionin Vlashtica është pushtuar kuota dominuese e lartë 915 m. Aksioni ka përfunduar në muajin tetor të vitit 1992 me pushtimin e Vlashticës, Majës së Ilisë (Ilijin vrh), Buvavcit dhe linjës Sërnjak – Orah – Bobovishte – Gradina. Në fushëbetëjen e Dubrovnikut situata e tillë ka mbetur fare deri në muajin dhjetor të vitit 1995, kur është nënshkruar Marrëveshja Paqësore e Daytonit, me të cilën ka përfunduar lufta në B dhe H, por edhe pas të cilës ka pasuar edhe tërheqja e forcave ushtarake nga rrethina e Dubrovnikut.⁷⁶

Është e vështirë të flitet mbi përmasat e dëmit. Është interesante se si në datën 8 dhjetor, „Komisioni“, midis të tjerash i përbërë edhe nga oficerë të APJ-së, e ka vizituar Qytetin e Vjetër dhe i ka bërë shënimet kornizë mbi

dëmtimet. Trupi gjykues, në aktgjykime konstaton se si „Komisioni“ nuk i ka vizituar të gjitha zonat dhe, së këndejmi, të dhënat e cekura nuk janë absolutisht të besueshme. Është e pakontestueshme se si Qyteti dhe pjesa më e madhe e komunës dubrovnikase kanë përjetuar dëme të mëdha materiale. Në vet bërthamën e qytetit janë shkatërruar shumë përmendore kulturore të kategorisë së lartë. Vetëm në një sulm prej dymbëdhjetë orëve në bërthamën e vjetër të qytetit janë dëmtuar rëndë rreth 30% e objekteve.⁷⁷

Në Trsten është djegur dhe është shkatërruar arboretumi 500 vjet i vjetër. Janë shkatërruar plotësisht 2.127 shtëpi, kurse 7.771 banorë kanë mbetur pa kulm mbi kokë. Është shkatërruar edhe porti ajror në Komunën fqinje Konavle. Mbi shumën dhe vlerën e dëmit të shkaktuar është e vështirë të shkruhet, por ekzistojnë të dhëna se vetëm në bregdet dhe në ishuj është shkaktuar dëm prej rreth 100 329 134 DEM (Marka Gjermane).⁷⁸

Gjatë veprimeve luftarake në Dubrovnik, në rrethinën e tij dhe me rastin e pastrimit të rrethinës dubrovnikase si dhe gjatë mbrojtjes aktive të pikave të prekura, janë vrarë 182 luftëtarë kroat dhe 11 pjesëtarë të Mbrojtjes Popullore nga Qarku i Neretvës-Dubrovnikut, 235 luftëtarë të trupave që kanë ardhur nga pjesë të tjera të Kroacisë si dhe 92 civilë.⁷⁹ Një pjesë e veteranëve të Dubrovnikut janë zënë rob dhe janë dërguar në kampe të përqendrimit në Bileqë (B dhe H) dhe në Morinj (Mali i Zi). Në anën tjetër të betejës kishte disa qindra ushtarë të vrarë, prej tyre rreth 250 nga hapësira e Trebinjës, por viktima civile nuk ka pasur.

3. Një politikë diametralisht e vendosur ndaj konceptimit njerëzor

Kohën e luftës dhe gjendjen në Trebinje në kuadër të memoareve të tij e ka përshkruar edhe Gjuro Kriste, në kohën e tij drejtor i shkollës fillore në Trebimle, fshat jo larg nga Trebinja si dhe veprimtar shumëvjeçar në fushën e kulturës në qytetin e Trebinjës. Kriste e përshkruan gjendjen kaotike në Trebinje si dhe e vë në spikamë se si

75 Lëndë e provave nr. P61, separatori 39; Sllobodan Vuković P. 5990-5993; 5827.

76 Ibid. f. 112-115.

77 V. Vierda, Analizë e Entit për Rindërtimin e Dubrovnikut, Qendra Muzeale e Dokumentacionit, Dubrovnik, 2007.

78 J. Cariq, Shkatërrimet dhe dëmet e luftës në bregdetin dubrovnikas në Luftës Atdhetare 1991-1992 në fondin e banesave, Përmbledhje e bregdetit dhe e ishujve dubrovnikas IV, Primorac, Dubrovnik, 1993.

qyteti ka qenë plot me rezervistë, me mjekra të gjata, të armatosur mirë.⁸⁰ Kriste dëshmon se si pozita e joserbëve ka qenë posaçërisht e vështirë si dhe se si informatat mbi sulmet edhe nuk i kanë pasur.⁸¹

Shumica e boshnjakëve, si dhe pothuajse të gjithë kroatët, kanë refuzuar për të hyrë në ushtrinë e Republika Srpska dhe për të shkuar në Dubrovnik. Pasi që policia ia ka arrestuar të dy djemtë, si qytetar i shquar i Trebinjës ia ka dalë të arrij deri te koloneli dhe ia ka shtruar pyetjen si më poshtë: *Zotëri kolonel, sikur si serb të ndodheshit në Dubrovnik, kurse sikur ushtria kroate të nisej për në Trebinje, si do të ndjeheshit ju në uniformën e ushtrisë kroate, aq më shumë sikur të kishit lindur në Trebinje?*, pyetje në të cilën koloneli është përgjigjur se si ai nuk do t'ia lejonte këtë vetes. Koloneli ia ka lejuar Kristit të vizitojë djemtë e tij të paraburgosur, kurse në shënimet e tij ai dëshmon mbi tmerret në të cilat ka hasur në atë hapësirë, në të cilën do të ndodheshin 3 boshnjak (mysliman) dhe 3 kroat, të cilët kanë refuzuar për të veshur uniformat dhe për t'u nisur në sulm kundër Dubrovnikut.⁸²

Është interesant konstatimi i Kriste i cili e ka kaluar luftën në Trebinje dhe i cili thotë se si çdo ditë i kanë dëgjuar të shtënat e zjarrit mbi Dubrovnikun, por edhe se si janë ndjerë rehat kur granata do të binte në Trebinje, edhe pse frikoheshin se mund të vdisnin nga të vetët.

Një dokument posaçërisht interesant është edhe Karta e Miqësisë dhe e Përkushtimit ndaj Dubrovnikut e miratuar në muajin dhjetor të vitit 1991 nga Këshilli Komunal i organizatës myslimane boshnjake në Trebinje. Në kuadër të së njëjtës, banorët e së njëjtës e kanë vënë në spikamë se si kjo Kartë „përbënë vazhdimësinë e dëshmisë së përkushtimit, të miqësisë dhe të fqinjësisë së mirë midis Bosnjës dhe Dubrovnikut, midis boshnjakëve dhe dubrovnikasve.“

Karta përmban edhe lutjen për falje, në të cilën e theksojnë se si nuk kanë „forcë dhe pushtet që të të ndihmojmë ashtu siç banët dhe mbretërit tanë të ndritshëm kanë mundur. Ty, strehës më të bukur të rinisë dhe të dashurisë sonë. Të vetmen që kemi mundur, ne edhe e kemi bërë, ne kemi refuzuar, edhe kusht të humbjes së punës dhe të vendbanimit, për të shtë në rininë dhe në dashurinë tonë. Me shpresën se një ditë prapë do të na pranosh në kraharorin tënd të ngrohtë e shkëmbor, të lutemi – të na falësh neve, sepse ata nuk e dinë se çka bëjnë.“⁸³

Në kuadër të ekspozesë nuk mundemi të mos i theksojmë protestat e organizuara në shenjë të përkrahjes së Dubrovnikut. Në Cetinje, në zemrën e Malit të Zi, janë mbajtur dy protesta. Protesta e parë kundër luftës është mbajtur në datën 3 dhjetor të vitit 1991, në të cilën më shumë se 10.000 malazias e kanë shprehur keqardhjen e tyre për shkak të sulmeve mbi Dubrovnikun dhe kanë kërkuar falje. Protesta e dytë është mbajtur në datën 1 shkurt të vitit 1992 dhe me anë të saj, me anë të këngës „Nga Lovçeni zana qanë, të na falësh Dubrovnik“ i është dërguar mesazhi Sllobodan Milosheviqit se si janë kundër pjesëmarrjes së ushtarëve malazez në sulmet mbi Dubrovnikun. Në Beograd e njëjta protestë kundër luftës është mbajtur me moton „Le ta presim urrejtjen që ta ndërpresim luftën“ në kuadër të së cilës pranë qytetarëve kanë qëndruar artist të njohur, kompozitor dhe aktorë si Mirjan Karanoviqi dhe Rade Sherbetxhija, të cilët së bashku kanë kënduar „Unë nuk mund të luftoj kundër mikut tim.“ Është organizuar edhe nënshkrimi i peticionit për Dubrovnikun në Fakultetin Filozofik në Beograd. Gjatë protestës është theksuar miqësia tradicionale e Dubrovnikut dhe e rrethinës së tij hercegovinase, duke vënë në spikamë shembuj se si fshatrat Konavala dhe të ato bregdetit dubrovnikas qysh nga koha e kryengritjes së Nevesinjes iu kanë ofruar strehim familjeve

79 M. Gjurash, Regjistri i viktimave të qarkut të neretvës-dubrovnikut në Glas Grada, numër 298, marrë në datën 3 dhjetor të vitit 2010., f. 5.

80 Gj. Kriste, MORAshnica – Pamje të një kohe, Ragusa, Dubrovnik, 2007., f. 170-171.

81 „Në prag të ditës, D“ (1 tetor i vitit 1991) me kureshtje e kemi vëzhguar çfarëdo informacioni mbi situatën momentale. Por kush do të të jepte informacion? Tashmë e disa muaj ndjehet ndryshimi i madh në sjelljen e serbëve ndaj kroatëve. Nëse bëhet bisedë, atëherë ajo është për temat e zakonshme nga jeta e përditshme. Asgjë mbi politikën, sepse këtu ka vetëm një politikë, në mënyrë diametrale të vendosur për konceptimin tonë.“ (Gjuro Kriste)

82 Ibid. f. 176.

83 Teksti i Kartës së Përkushtimit ndaj Qytetit të Dubrovnikut është në dispozicion në www.behar.hr/1991-bosnjaci-trebinja-pisu-povelju-odanosti-dubrovniku, publikuar në datën 23.09.2013., në dispozicion në datën 05.01.2014.

të dëbuara nga Popovo polje, Bileqe dhe Stara Crna Gore. Po ashtu është theksuar se si gjatë Luftës së Dytë Botërore në Dubrovnik është tubuar jo vetëm ndihma për partizanët, por edhe se dubrovnikasit i kanë dërguar popullatës së Popovo poljes krip dhe gurrkali ose sulfurin blu për kafshët dhe për kultivimin e vreshtarisë.⁸⁴

4. Ndryshimet demografike dhe marrëdhëniet postkonfliktuale të dyja qyteteve

Siç është theksuar tashmë, sipas regjistrimit të popullatës së vitit 1991, popullatën e Trebinjës e kanë përbërë rreth 69% serb, 19,5% boshnjak (myslimanë), 1,5% kroat, 6% jugosllav dhe 4% të tjerë. Edhe pse nuk i kemi rezultatet e regjistrimit zyrtar të popullsisë, sipas situatës *de facto*, por edhe sipas hulumtimeve të zhvilluara nga ana e CIA World Factbook të vitit 2008, Trebinja është një qytet etnikisht i pastër, përkatësisht qytet në të cilin sot jetojnë mbi 95% serb. Kroat pothuajse edhe nuk ka, kurse boshnjakët, përndryshe të shpërngulur anë e kënd Evropës, më së shumti në Danimarkë dhe Suedi, në Trebinje kthehen vetëm gjatë periudhës së verës.

Në Dubrovnik, sipas regjistrimit të vitit 1991 kanë jetuar 77,5% kroat, 8,5% serb, 5,5% myslimanë, 2% jugosllav, 1% malazez si dhe 5% të tjerë. Sipas regjistrimit të vitit 2011, në Dubrovnik jetojnë 90,4% kroat, 3,5% boshnjak, 2,7% serb, 0,5% malazez si dhe rreth 3% të tjerë. Është e dukshme se si në Dubrovnik në masë të madhe është zvogëluar numrit i popullatës serbe. Sipas dëshmive të popullatës lokale, shumica e serbëve e kanë braktisur Dubrovnikun menjëherë para shpërthimit të konfliktit të armatosur të vitit 1991. Edhe pse nuk ka krime të regjistruara mbi popullatën serbe në Dubrovnik, konsiderojmë se rrethanat postkonfliktuale dhe gjendja e të drejtave të njeriut si dhe hedhja dhe ekskluziviteti i fajit nuk e kanë mundësuar kthimin e sigurt të popullatës. Një pjesë e popullatës serbe kanë mbetur në Dubrovniku, derisa shumica i kanë këmbyer ose i kanë shitur pronat e tyre dhe, së këndejmi, kanë kërkuar një jetë të re diku tjetër, me shumicë pikërisht në Trebinje.

Si edhe në hapësirën e ish Jugosllavisë, për shkak të situatës së gjithmbarshme, ka rezultuar deri te ndarjet e mëdha midis njerëzve. Për shkak të hedhjes së fajit që në fillim të vet konfliktit të armatosur, por edhe për shkak të

mashtimeve të kreut politik, krijohet urrejtja ndaj të gjithë pjesëtarëve të këtij apo të atij populli. Në diskursin kroat formohen tregime mbi përgjegjësinë e serbëve trebinjas për sulmet mbi Dubrovnikun, derisa, në anën tjetër, paraqiten arsyetime se si të gjitha ngjarjet kanë përbërë asgjë më tepër se sa mbrojtje të popullit serb në hapësirën e Dubrovnikut gjatë „shpërbërjes kundërkushtetuese të shtetit të përbashkët. Në një periudhë shumë të shkurtë kohore delegitimohet ish shteti dhe, së këndejmi, të gjitha ngjarjet e deriatëhershme fillojnë të vështrohen si mashtime. Kroatët pohojnë se si Jugosllavia ka përfaqësuar asgjë pos një Serbi të Madhe, derisa serbët e theksojnë se si kjo ka qenë një aleancë në kuadër të së cilës kanë sunduar kroatët, në krye me udhëheqësin e “tyre” Josip Brozin me qëllim të përçarjes së serbëve dhe të shkatërrimit të traditës monarkiste serbe. Pavarësisht nga të gjitha, urrejtja dhe shpëputja e marrëdhënive midis popullatës bëhet realitet i pasluftës. Popullata pozicionohet në dy gaborre, në dy qytete në një largësi prej tridhjetë kilometrash dhe të gjitha aspektet e bashkëpunimit të përbashkët e pjesërisht edhe ato të komunikimit ndërpriten. Niveli i rritur i urrejtjes e arrin pikën kulmore pikërisht pas përfundimit të luftës, kur partitë kombëtare politike kanë filluar të mbledhin pikë politike duke shpallur pikërisht vetveten „mur mbrojtës” nga agresori në anën tjetër.

5. Ndjekja penale për sulmet në rajonin e Dubrovnikut

Në kuadër të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë, për shkak të krimeve të kryera gjatë sulmeve në rajonin e komunës së Dubrovnikut janë ngritur shumë aktakuza.

Gjenerali Pavle Strugar është dënuar me dënimin e përbashkët prej tetë vitesh burgim për shkak të rolit të tij në granatimin e qytetit, me çka i ka shkelur ligjet dhe zakonet e luftës si dhe për shkak të shkatërrimit të ndërgjegjshëm dhe të dëmtimit të institucioneve religjioze, karitative, arsimore, artistike dhe shkencore, përmendoreve historike të kategorisë më të lartë si dhe veprave artistike dhe shkencore. Dënimi pas procedurës ankimore, për shkak të gjendjes shëndetësore të të dënuarit, është zvogëluar në dënimin në kohëzgjatje prej shtatë e gjysmë vitesh. Pas vuajtjes së dy

84 S. Prodanović, Shkatërrimet Petoljetka, Republika nr. 149, viti VIII, 1996., f. 21-25.

të tretave të dënimit, Strugari përkohësisht është lëshuar në liri. Miodrag Jokiçi (komandant i Sektorit 9 të marinës ushtarake të Bokës) është dënuar me 7 vite burgosje. Pas vuajtjes së dy të tretave të dënimit është lëshuar në liri.

Vlladimir (Rambo) Kovaçevići (komandant i batalionit të tretë të Brigadës së Motorizuar 472 të APJ-së nga Trebinja) është akuzuar së bashku me Strugarin⁸⁵, por rasti i tij, për shkak të paaftësisë procesore në lidhje me sëmundjen shpirtërore të diagnostikuar, i është lëshuar gjyqësorit vendor.⁸⁶

Për veprimet në zonën e Dubrovnikut ka qenë i akuzuar edhe Slobodan Millosheviçi, por procedura është ndërprerë për shkak të vdekjes së të akuzuarit në datën 6 mars të vitit 2006.

Është akuzuar edhe Bozhidar Vuçureviçi, në kohë të luftës kryetar i Trebinjës, kryetar i zonës autonome serbe të Hercegovinës, kryetar i shtabit të krizës dhe i shtabit të luftës i komunës së Trebinjës si dhe kryetar i kryesisë së luftës së komunës së Trebinjës. Prokuroria Shtetërore e Qarkut në Dubrovnik e ka ngritur aktakuzën kundër Vuçureviçit për shkak të krimeve të luftës kundër popullatës civile dubrovnikase të rrethinës si dhe shkatërrimit të përmendoreve kulturore dhe historike. Vuçureviçi gjithsesi se, pos për krimet e kryera, do të mbahet mend edhe për deklaratën e tij: „Do ta krijojmë në një Dubrovnik edhe më të bukur e edhe më të vjetër!” Vuçureviçi në muajin prill të vitit 2011 është privuar nga liria në kalimin kufitar në Serbi dhe është paraburgosur në bazë të urdhër-arrestit ndërkombëtar. Dy muaj pas kësaj, Gjykata e Lartë në Beograd e ka sjellë Vendimin mbi lëshimin e përkohshëm në liri me kusht që të mos e lëshoj Serbinë deri në përfundimin e procedurës së ekstradimit. Pas një kohe të shkurtë pas kësaj, Vuçureviçi nisat për në Trebinje, kurse Gjykata e Apelit në Beograd e ka sjellë vendimin mbi atë se si nuk ka kushte për ekstradim, pasi që Vuçureviçi nuk gjendet në territorin e Serbisë.

Prokuroria shtetërore e Qarkut në Dubrovnik në datën 4 dhjetor të vitit 2009 ka ngritur aktakuza kundër komandantit të grupit të 2-të operativ – gjeneralit Jevrem Cokiçit, Mile Ruzhinovskit dhe Pavle Strugarit, pastaj kundër komandantit të sektorit të 9-të të marinës ushtarake, admiralit Miodrag Jokiçit dhe zëvendësit të tij, kapitenit të marinës Millan Zecit, komandantit të grupit të dytë taktik, gjeneralit Stankoviç, komandantit të Brigadës së motorizuar 472, nënkolonelit Viçiç dhe zëvendësit të tij, majorit Komar. Po ashtu janë akuzuar kapiteni klasit të I-rë, Vlladimir Kovaçevići i quajtur Rambo, komandanti i batalionit të 3-të të brigadës së motorizuar 472 dhe togeri i marinës Gvozdenoviç, komandant i topave raketor numër 403.⁸⁷

Në datën 15 maj të vitit 2010, Gjykata e Lartë në Podgoricë e ka shqiptuar aktgjykimin (jo të formës së prerë) për krimet e luftës të kryera në kampin e përqendrimit në Morinj pranë Kotorit. Zlatko Tarle është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 1,5 viti, Mllagjan Govedarica në kohëzgjatje prej 2 vitesh, Ivo Gojniçi në kohëzgjatje prej 2,5 vitesh, Boro Gligiçi në kohëzgjatje prej 3 vitesh, Shpiro Luçiçi në kohëzgjatje prej 5 vitesh, kurse Ivo Menzalin, i cili ndodhet në arrati, në kohëzgjatje prej 4 vitesh burgim. Të dënuarit, sipas aktakuzës, si pjesëtarë aktiv dhe rezervë të ish-APJ-së, kanë kryer krime të luftës kundër civilëve dhe të burgosurve të luftës të zonës së Dubrovnikut. Gjykata e Apelit në Mal të Zi, në datën 7 dhjetor të vitit 2010, i ka anuluar aktgjykimet dhe lënda është kthyer në procedurën e shkallës së parë para Gjykatës së Lartë.⁸⁸

6. Marrëdhëniet 20 vite pas konfliktit: mundësitë për krijimin e mekanizave të drejtësisë tranzicionale

Drejtësia tranzicionale përbënë një fushë, e cila i hulumton mënyrat se si duhet të sjellemi ndaj shkeljeve të drejtave të njeriut në të kaluarën në shoqëritë në tranzicion, kurse

85 Në aktakuzë thuhet se si personat janë të akuzuar, sepse: „Kanë ndezur pa qëllim më shumë se qindra projektilet në qytetin e Vjetër dubrovnikas, si rezultat i të cilave dy civilë e kanë humbur jetën, Pavo Urban dhe Tonçi Skočko, kurse tre civilë janë plagosur”, ndërkaq “plotësisht janë shkatërruar ose djegur gjashtë përmendore historike dhe arkitektonike nën mbrojtjen e UNESCO-s dhe janë dëmtuar 46 ndërtesa dhe objekte”.

86 „Vlladimir Rambo Kovaçević i paaftë për gjykim“, në www.blic.rs, publikuar në datën 25. 05. 2012., në dispozicion në datën 02. 01. 2014.

87 Kumtesë e Prokurorisë Shtetërore të Qarkut në Dubrovnik, në Slobodna Dalmacija, të datës 04. 12. 2009, f. 7-8.

88 Kumtesë mbi anulimin e aktgjykimet: Aktgjykim i anuluar për krimet ndaj të burgosurve kroat në Morinj, në Jutarnji list, e datës 07.12.2010. f. 12.

është një nga instrumentet më të rëndësishme të procesit të demokratizimit, që e udhëheqin organizatat ndërkombëtare duke qenë se mund të funksionojë si katalizator efikas i pajtimit postkomunist dhe i stabilizimit.⁸⁹

Qëllimi themelor është për të ruajtur paqen e qëndrueshme si dhe për të ndihmuar gjatë demokratizimit. Sipas Qendrës Ndërkombëtare për drejtësi tranzicionale, veprimet e drejtësisë tranzicionale përfshijnë:

- a) Ndjekjen penale dhe format jashtëgjyqësore të ndjekjes (siç janë mekanizmat për konstatimin e së vërtetës);
- b) Reparacionet për viktimat si dhe përpjekjet për të plotësuar nevojat e tyre, ku mund ta përfshijmë edhe procesin e memorializimit;
- c) Transformimin e sistemit të sigurisë dhe heqjen potenciale të shkelësve të të drejtave të njeriut nga institucionet publike dhe

ç Reformën e institucioneve publike me qëllim që të parandalohet shkelja e përsëritur e të drejtave të njeriut nga e kaluara.⁹⁰

Nëse fillojmë të analizojmë sipas treguesve të dhënë marrëdhëniet e dy qyteteve në periudhën e pasluftës, lirisht mund të konstatojmë se 24 vite nga vet sulmi mbi Dubrovnikun, por edhe 20 vite nga përfundimi zyrtar i çdo lloji të konfliktit të armatosur në hapësirën e ish Jugosllavisë, rezultatet në lidhje me çështjen e krijimit të mekanizmave të drejtësisë tranzicionale janë minimale. Në kuadër të ndjekjes penale rezultatet janë minore. Ata, të cilët janë dënuar me aktgjykime të plotfuqishme, tashmë janë të liruar. Disave iu janë anuluar aktgjykimet, kurse disa të tjerë janë të paqasshëm për organet e ndjekjes penale.

Kur është fjala për konstatimin e së vërtetës, këtu madje as që kemi provuar diçka si më të rëndësishme. Secili i ka shkruar

faqet e historisë së vet. Banorët e njërit qytet e kanë tregimin e vet dhe janë absolutisht të bindur në te, derisa, nga ana tjetër, kemi kriter tjetër të vështrimit në hollësitë e njëjta.

Reparacione nuk ka, gjë që deri diku është e lidhur edhe me mos konstatimin e fajësisë. Kur është fjala për vet ripërtëritjen e pasluftës të Dubrovnikut, e cila ka kushtuar rreth 80.000.000 US \$, një pjesë është siguruar nga buxheti i Republikës së Kroacisë, përkatësisht nga Ministria e Kulturës për Programin e ripërtëritjes së Dubrovnikut, derisa pjesa tjetër e mbetur është siguruar nga burime të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe UNESCO-n dhe donacionet. Është interesant për të përmendur se si Mile Gjukanoviç, kryetari i Republikës së Malit të Zi, në emrin e tij dhe të qytetarëve të Malit të Zi, në vitin 2000 ka kërkuar falje për sulmin mbi Dubrovnikun si dhe për të gjithë dhembjen, vrasjet dhe humbjet materiale, të cilat i kanë shkaktuar malazetë në përbërje të APJ-së. Pas një vargu të madh të viteve në mënyrë aktive bëhen negociata edhe lidhur me reparacionet monetare të Malit të Zi për sulmin në Dubrovnikun, kurse për pjesën e parë tashmë është arritur marrëveshja. Përndryshe, në vitin 2005, Mali i Zi e ka nënshkruar Memorandumin, me të cilin janë obliguar për t'i paguar kompanisë „Dubrovačko mljekarstvo“ 375.000 euro për 650 lopë të plaçkitura në luftë nga ferma në fshatin Gruda, komuna e Konavles. Ky Memorandum ka nxitur debate të ashpra midis pozitës dhe opozitës së Malit të Zi, kurse në të njëjtën kohë ka përfaqësuar edhe hapje të temës në diskursin publik malazet mbi ngjarjet e vitit 1991. Vet akti i kësaj pagese *de facto* e vërteton pranimin e fajësisë, nëse për asgjë tjetër, atëherë për veprimet e pandershme në hapësirën e një shteti tjetër si dhe për mundësinë e hapjes së çështjeve të tjera me qëllim të vendosjes së drejtësisë tranzicionale. Në vitin 2008, kryetari i Kuvendit të komunës së Trebinjës, Nikolla Sekuloviç me keqardhje ka konstatuar se si është pjesë e së keqes, e cila i ka ndodhur Dubrovnikut edhe nga ana trebinjase. Shoqata Klubi Alternativ në vitin 2012 e ka filluar projektin në kuadër të të cilit kanë kërkuar nga pushteti lokal që të shprehë kërkimfaljen duke qenë se „*Trebinja nuk mundet dhe nuk dëshiron të jetojë e getoizuar.*“⁹¹ Në muajin prill të vitit 2012 është mbajtur

89 Përkufizimi sipas Qendrës Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale, www.ictj.org, qasur në datën 13.01.2015.

90 Përkufizimi sipas Qendrës Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale, www.ictj.org, qasur në datën 13.01.2015.

91 Pajtimi i Dubrovnikut dhe i Trebinjës, Al Jazeera Balkans, www.balkans.aljazeera.net, publikuar në datën 04. 01. 2012., qasur në datën 14. 01. 2015.

takimi i parë i kryetarëve të Trebinjës dhe të Dubrovnikut me rastin e të cilit Dobroslav Çuk, shef i komunës së Trebinjës ka shprehur keqardhjen për krejt atë çfarë ka ndodhur.⁹² Ai ua ka qartësuar gazetarëve se si është fjala për keqardhjen, dhe jo për kërkimfaljen, duke qenë se kërkimfalja duhet të jetë e dyanshme.

Vet shkella e të drejtave të njeriut, para së gjithash humbjet njerëzore, por edhe nderimi i atyre të cilët e kanë mbrojtur popullin, administrata e qytetit të Dubrovnikut si dhe disa organizata joqeveritare, janë shënuar me ndërtimin e përmendoreve. Kështu, për shembull, në hapësirën e Qytetit të Dubrovnikut, i kemi 14 përmendore që burojnë nga Lufta atdhetare. Prej tyre, 11 përmendore i janë kushtuar luftëtarëve mbrojtës të rënë të qytetit dhe 1 të gjithë mbrojtësve të qytetit, derisa 2 i janë kushtuar viktimave civile të luftës. Në kuadër të regjistrit të përmendoreve, le t'i vëmë në spikamë edhe pllakat publikisht të shpallura me shënimet për dëmtimet e bërthamës së vjetër të qytetit, të cilat sigurisht se përbëjnë një segment të rëndësishëm të shënimit të sulmeve në Dubrovnikun në vitin 1991.⁹³

Në verën e vitit 2011 në Trebinje është ngritur „Përmendorja për të gjithë luftëtarët e rënë në mbrojtjen e qytetit“, në përkujtim të të gjithë ushtarëve serb nga hapësira e Trebinjës, të cilët kanë „rënë duke mbrojtur qytetin dhe duke luftuar për idealet e shenja të popullit serb – patriotizmin dhe lirinë“, siç

e ka vënë në spikamë Dobroslav Çuk, kryetar në atë kohë i Komunës së Trebinjës.

Vet sistemi i sigurisë nuk ka kaluar ndonjë transformim si më të madh kuadrovik⁹⁴, por mendoj se mundemi për të thënë se si shërbimet dubrovnikase, por edhe ato trebinjase, janë të obliguara për garantimin e sigurisë në hapësirat e këtyre dy qyteteve në mënyrë efikase për çka dëshmon edhe fakti se dubrovnikasit gjithnjë e më shpesh e vizitojnë Trebinjën, kurse trebinjasit Dubrovnikun.

Në kohët e fundit, me gjithë mungesën e marrëdhënieve të drejtpërdrejta midis dy njësive të vetëqeverimit lokal, por edhe faktit se si të dyja qytetet i ndajnë jo vetëm dy shtete, por edhe kufiri i strukturës supranacionale të Bashkimit Evropian, bashkëpunimi midis popullatës është më se i hetueshëm. Dubrovnikat shkojnë në Trebinje për të blerë gjëra të ndryshme, blejnë pemë dhe perime vendore, rroba dhe veshmbathje, i riparojnë automobilët, kurse në kohët e fundit gjithnjë e më shumë përdorin edhe shërbimet mjekësore. Shumë dubrovnikase janë çdo të shtunë në tregun trebinjas dhe pohojnë se si prodhimet janë më natyrale, më të shëndetshme dhe më të lira se sa në Dubrovnik. Çmimet në Trebinje shprehen në marka të konvertueshme, kurse në kohët e fundit gjithnjë e më shumë bëhen pagesat edhe në kunat kroate dhe në euro.⁹⁵Në një intervistë për Klix.ba, një shitëse me emrin Zorica e thekson se si për te janë „të gjithë blerësit të

92 Deklaratë e Dobrosllav Qukut, kryetarit të komunës së Trebinjës në takimin e parë të pasluftës me kryetarin e Dubrovnikut: „Si kryetar i bashkisë së Trebinjës me bashkëqytetarët e mi thellë dhe sinqerisht e ndjej keqardhjen për krejt atë që na ka ndodhur dhe për secilën viktimë të pafajshme si dhe për secilin dëm, e madje edhe për atë më të voglin që iu është shkaktuar juve, fqinjëve tanë dhe qytetit të Dubrovnikut. Besoj se edhe i keni të njëjtat ndjenja dhe se ka ardhur momenti kur njëmend jemi të gatshëm që së bashku të ndjejmë keqardhjen për atë që na ka ndodhur, që të dëshirojmë që diçka e ngjashme të mos përsëritet më kurrë dhe që t'ia falim njëri-tjetrit në frymën e krishterë, ashtu siç jo fort moti na kanë mësuar peshkopi hercegovas i zahumljes dhe peshkopi bregdetasi Grigorijsi dhe peshkopi dubrovnikas.“

93 Përmendoret e dala nga lufta atdhetare në zonën e Dubrovnikut: 1. Përmendorja për luftëtarët e rënë në Tërsten; 2. Përmendorja për 101 luftëtarët kroat të vrarë në betejat rreth Osojinkut; 3. Përmendorja për luftëtarët në Mërçevë; 4. Kryqi Qendror në kujtim të të gjithë luftëtarëve të rënë gjatë luftës atdhetare; 5. Përmendorja për luftëtarët e rënë boshnjak (Mysliman); 6. Përmendore për policët-luftëtarët e rënë; 7. Përmendore për luftëtarët dubrovnikas në Pilame; 8. Përmendore për luftëtarët e rënë në Sustjepan; 9. Përmendore për luftëtarët në Stari Mokoshici; 10. Pllakë përkujtimore për nëntë civilët e vrarë në granatimet e datës 07.10.1991 Novi Mokoshici; 11. Përmendore për luftëtarët në Komolc; 12. Përmendore për luftëtarët e rënë në Sërgj; 13. Përmendore për luftëtarët e rënë në fshatin Bosanka; 14. Përmendore për viktimat civile të luftës në Parkun e viktimave të pafajshme të luftës (në ndërtim e sipër); 15. Pllakat publikisht të shpallura me shenjat e „dëmtimeve të shkaktuara nga agresioni i APJ-së, serbëve dhe malazezve në Dubrovnik 1991/92.“

94 Klubi Alternativ në Trebinja në vitin 2012 ka kërkuar lustrimin për të gjithë ata të cilët gjatë njëzet viteve të kaluara e kanë kultivuar kultin e fashizmit, të çetnikizmit, të ustashizmit dhe të nacional-klerikalizmit si dhe të të gjitha fenomeneve devijonte dhe të rrezikshme për shoqërinë.

95 Dubrovnikasit në shopping shkojnë në Trebinje, blejnë pemë, perime, por edhe veshmbathje, Klix.ba, www.klix.ba, publikuar në datën 21.07.2013., e qasshme në datën 14. 01. 2015.

njëjtë dhe se si ka mjaft myshteri të rregullt nga Dubrovniku, të cilët e thërrasin më herët dhe i bëjnë porosinë se çfarë gjërash të përgatiten për ta. Zorica e thekson se si dubrovnikasit ia dinë vlerën produkteve vendore, pa shtesa artificiale, por edhe çmimeve të volitshme“.

Është e rëndësishme të ceket se si gjatë kohëve të fundit disa agjenci të caktuara turistike nga Dubrovniku në periudhën e verës, autobusët me mysafirë të huaj i dërgojnë në vizita në Trebinje në degustime të lira të ushqimeve tradicionale. Vet vizita e Trebinjës për mysafirët e huaj përbënë përjetim si dhe një befasi në largësi prej 30 minutash prej Dubrovnikut. Një qytezë e vogël hercegovinase, e vendosur në Trebishnicën e ftohtë, e rrethuar nga guri i djegur si dhe me një larmi të mbetjeve të trashëgimisë kulturore si nga periudha osmane⁹⁶, ashtu edhe nga ajo austrohungareze.

Gjatë ditëve të verës, plazhet dubrovnikase gjithnjë e më shumë janë të mbushura me trebinjas, qoftë të popullatës përherë të vendosur, qoftë të diasporës së shpërngulur boshnjake. Në mënyrë që të lahen në ndonjërin nga plazhet në afërsi të Dubrovnikut, trebinjasit, me automobil, në kushte ideale arrijnë atje për 30 minuta. Në ditët e verës nuk i pengon as kontrolli kufitar, i cili din të rezultojë edhe në pritje deri në dy orë, për çka dëshmojnë plazhet plotë në linjen Kupari – Srebreno.

Sipas mendimit tonë, një nga projektet më të rëndësishme, i cili i lidh të dyja qytetet, është edhe ripërtëritja e ish linjës hekurudhore me binarë të ngushtë në relacionin Çapljini – Dubrovnik, në kuadër të projektit „Me biçikleta nëpër histori e përcjellim Çirën“ që financohet nga mjetet e Instrumentit të Para-anëtarësimit (IPA) për bashkëpunimin përtejkuftar dhe i cili është nënshkruar në datën 18 dhjetor të vitit 2014. Projekti përfshin rindërtimin e pjesës së rrugës me qëllim të ndërtimit të shtegut biciklistik në atë hapësirë. Pjesa, e cila ka të bëjë me B dhe H, kurse bartës i të cilës është Ndërmarrja Publike Vjetrenica, e përfshin komunën e Çapljinit, Neumin, Ravnon dhe bashkësinë Turistike të Qytetit të Trebinjës, dhe ka një vlerë prej 296.000 eurove⁹⁷

7. Përfundim

Vlerësimet e ndryshme të operacioneve ushtarake në zonën e Dubrovnikut ende nxisin debate të ashpra midis historianëve dhe politikanëve të të dyja palëve. Shumë çështje ende mbesin pa një përgjigje të qartë. Kush i ka iniciuar operacionet ushtarake në zonën e Dubrovnikut dhe kush duhet të bartë përgjegjësinë për pasojat katastrofale të kësaj aventure? A është përgjegjëse për këtë fiasco ushtarake dhe politike vetëm APJ apo në mënyrë solidare ata përgjigjen së bashku me malazezët? Kush është fajtor në kreun politik? A ka pasur fare rrethim ose njësitë e APJ-së dhe vullnetarët malazez kanë hyrë në territorin e Kroacisë me qëllim që njëmend të “çlirojnë” qytetarët e vet nga përqafimi vdekjeprurës “i qeverisë ustashe”? e kështu me radhë. Mendoj se shumë përgjigje qartazi gjenden në kuadër të aktgjykimeve të Tribunalit të Hagës, në të njëjtën kohë edhe e vërtetë gjyqësisht e vërtetuar mbi vet sulmin në qytet. Në punim i kemi përkrahur pikërisht ato fakte. Tribunali i Hagës, në lidhje me çështjen e sulmeve mbi Dubrovnikun, nuk i ka kënaqur plotësisht nevojat e viktimave për ndjekjen penale të personave përgjegjës. Por, pavarësisht nga kjo, për faktet mbi veprimet e luftës të vërtetuara në kuadër të një organi ndërkombëtar, por edhe precedentit juridik se si pavarësisht nga rrjedha e luftës edhe kreu më i lartë mund të dënohet njëmend, duhet t’i jemi mirënjohës.

Në kohën kur kanë filluar negociatat mbi ndërprerjen e rrethimit të Dubrovnikut, ka qenë bërë plotësisht e qartë se si fushata e gjithmbarshme ka qenë një fiasco e APJ-së. Është dëshmuar se si fushata „Luftë për paqe“ është shndërruar në një ankth për establishmentin ushtarak të asaj kohe, si në marrëdhëniet vendore, ashtu edhe në ato ndërkombëtare. Një numër i madh i qytetarëve kanë qenë skeptik dhe dyshues në lidhje me gjithçka. Duhet ta theksojmë se si shtypi i asaj kohe plotësisht e ka lajthitur publikun si dhe të theksohet se vetëm një pjesë e vogël ka mundur të di se njëmend për çka është fjala.

96 Mbetjet e kulturës osmane në Trebinje, duke përfshirë xhaminë në qytetin e vjetër, shkatërruar plotësisht nga strukturat qeverisëse, gjatë luftës në Bosnjë. Pas luftës vjen për rivendosjen ndërtesën e shkatërruar, të cilat do të diskutohet dhe përfundimin e punës.

97 EK i ka miratuar mjetet: Fillon rindërtimi i hekurudhës Çapljini – Dubrovnik, Klix.ba, www.klix.ba, publikuar në datën 22. 12. 2014., qasur në datën 14. 01. 2015.

Kur flasim me faktet e cekura, e theksojmë se si është e domosdoshme që ato të potencohen me qëllim të fillimit të pajtimit të njëmendët. Pajtimi e nënkupton ballafaqimin e elitave me të kaluarën, por edhe pajtimin në nivelin individual të qytetarëve të shteteve të ndryshme, përkatësisht, në rastin tonë, të dy qyteteve. Përgjegjësia politike është veprimi i parë. Kërkimfalja nga institucionet shtetërore duhet të përbëjë bazën për pajtimin e qytetarëve të “zakonshëm”. Ka nevojë që të përkulemi para viktimave, jo vetëm në mënyrë protokollare, ashtu siç e bëjnë këtë politikanët tanë, por sinqerisht dhe njëmend. Ka nevojë për një transformim shpirtëror dhe ideologjik. Pos pajtimit, në mënyrë të shprehur janë të rëndësishme edhe reparacionet, të cilat në kuptimin material edhe konkretisht e dëshmojnë kërkimfaljen ndaj viktimave. Nuk duhet të harrojmë se si prona e gjithmbarshme e popullatës kudo ku ka kaluar APJ ose trupat malaziasë plotësisht është shkatërruar dhe plaçkitur. Me gjasë edhe sot fëmijët, në hapësirat prej të cilave janë kryer sulmet, e shfrytëzojnë porcelanin e vjedhur ose madje diku në ndonjë fshat e shohin televizionin e dikujt, sipas të gjitha gjasave duke mos e ditur prejardhjen e të njëjtit.

Prapëseprapë, ekzistojnë edhe tregimet pozitive. Kështu, për shembull, peshkopi mostaras-duvanjas dhe trebinjas-mrkas Ratko Periq e thekson se kisha katolike

ka marrëdhënie shumë të mira me komunën e Trebinjës, si dhe atë se si ai numër i vogël i popullit kroat që është kthyer në Trebinje është pranuar mirë dhe respektuar. Një bashkëpunim shumë të mirë ka edhe ef. Husein Hoxhiqi, imami kryesor në Trebinje, i cili nga lufta, me përkrahjen e diasporës boshnjake, i ka rindërtuar dhjetë xhami në zonën e Trebinjës. Nuk mund të mos theksohen mesazhet e dërguara nga kryetari i ri trebinjas Sllavko Vuçureviqi, i cili në hapjen e Xhamisë së Sulltan Ahmetit në Trebinje në verën e vitit 2014 ka porositur se si dëshiron që prej momentit kur besimtarët e kalojnë pragun e tempullit të lutjes të ndjejnë një shpresë dhe një forcë të re dhe që edhe njëherë e edhe tjetrën ta ndajmë me fqinjët e tyre të besimeve të tjera dhe të kombeve të tjera, sepse ka shumë gjëra të cilat të gjithë në mënyrë të njëjtë i vlerësojmë. Vuçureviqi e ka theksuar se si dëshiron „që të gjithë më shumë të kthehemi nga ajo që na është e përbashkët, drejt asaj me të cilën jemi të ngjashëm, nga ajo që na bënë fqinjë dhe qytetarë të mirë.“ Në të njëjtën ngjarje, prifti Drazhen Tupanjani, prift trebinjas ka thënë se si „Çmenduria i ka rrënuar këto vlera të shenjta. Dashuria, pendimi, falja dhe arsyeja i ripërtërijnë. Për këtë arsye, së bashku me vëllezërit e mi priftërinj dhe me besimtarët, me ipeshkvin Grigorije sot këtu ua dërgoj përsëritjet dhe urimet e mia. Dhe ju përsërites juve në emër të të gjithë neve në fund me përsëritjet biblike dhe me atë të Kur'anit. Paqja qoftë me ju. Irini paci. Pax vobis. Selam alejkum.“

Aktgjykimi në lëndën *Veselin Vllahović Batko*

Nasir Muftić

Hyrje

Gjatë rrethimit të Sarajevës, vendbanime të shumta urbane, siç janë Ilixha, Dobrinja ose Gërbavica⁹⁸ kanë qenë të okupuara. Engjëjt e bardhë, Shqiponjat e bardha, Sheshelastit (Beli angjeli, Beli orlovi, Shesheljevci) dhe (para)formacione të tjera, nga muaji prill i vitit 1992 e deri tek ri-integrimi i Gërbavicës në pranverë të vitit 1996, kanë bërë kërdrinë në vendbanimet e pushtuara, kanë plaçkitur, dhunuar, torturuar dhe vrasur. Për nga ligësia dhe monstruozeziteti, dëshmitarët e mbijetuar më së shumti e mbajnë në mend Veselin Vllahović-Batkën, pjesëtarin e formacionit Engjëjt e bardhë, me të cilin deri në vrasjen e tij ka komanduar Zoran Vitković, kurse pastaj Predrag Jovančić.⁹⁹

Procesimi penal i kryerësit të veprave penale ndërkombëtare është një nga mekanizmat e drejtësisë tranzicionale. Konsiderohet si një mekanizëm klasik, i cili e ka për qëllim vërtetimin e shkeljeve të së drejtës humanitare nga ana e organeve të pushtetit gjyqësor kombëtar ose instancave gjyqësore ndërkombëtare dhe, në përputhje me këtë, e ka edhe përmbushjen e qëllimeve të drejtësisë tranzicionale:

konfirmimin e së vërtetës, legjitimitimin e bashkësisë politike, reformat tranzicionale, realizimin e reparacioneve dhe pajtimin.¹⁰⁰

Kur flitet mbi procedurat penale në kontekstin e drejtësisë tranzicionale, kryesisht vihet në pah rëndësia e procesimit të individëve, të cilët në kohën e tranzicionit kanë qenë në pozitë më të larta në hierarkinë civile ose ushtarake.

Procesimi i individëve çfarë është edhe Veselin Vllahović Batko, i individëve, të cilët nuk kanë qenë në pozitë të tilla, po të cilët, prapëseprapë, janë mbajtur në mend për brutalitetin dhe vrazhdësinë e tyre, ka rëndësi të madhe simbolike për të gjitha viktimat e tij dhe për të gjithë ata të cilët ndonjëherë janë takuar me ta ose janë frikuar nga takimi me ta. Popullata civile, e cila në atë periudhë ka jetuar në Gërbavicë dhe në vendbanimet përreth, ka qenë në pamëshirën e pjesëtarëve të grupeve ushtarake dhe paraushtarake, të cilat janë ndodhur në atë hapësirë. Përkundër të gjitha tmerreve, të cilat i kanë përjetuar, numrin më të madh të popullatës së mbijetuar të Gërbavicës dhe të vendbanimeve sarajevase përreth e simbolizon figura e Veselin Vllahovićit, i cili është

98 Vendbanimi sarajevas Gërbavica gjatë rrethimit të Sarajevës ka qenë nën kontrollin e korpusit sarajevo-romanias. (Prokurori kundër Galiqit [2006] GJPNJ, IT-98-29-A (GJPNJ)).

99 Antiq, Irena. "Fantazmat e së kaluarës gërbavice" (Aveti gërbavice prošlosti.) Helsinki Charter (Karta e Helsinkit), nr. 149-150 / 2011, 18-20.

100 Martina Fischer and Ljubinka Petrović-Ziemer (eds.) 2013. Trajtimi i së kaluarës në Ballkanin Perëndimor. Nismat për krijimin e paqes dhe Drejtësia Tranzicionale në Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi dhe Kroaci. (Dealing with the Past in the Western Balkans. Initiatives for Peacebuilding and Transitional Justice in Bosnia-Herzegovina, Serbia and Croatia. Berghof Report No. 18. Berlin: Berghof Foundation.

dalluar për egërsitë, të cilat i ka kryer. Në vazhdim do të bëhet një vështrim në aktgjykimin¹⁰¹, me të cilin Vllahoviç është shpallur fajtor për vrasjen e së paku 30 personave, si dhe për një numër të madh të plaçkitjeve, keqtrajttimeve dhe të dhunimeve.

Biografia

Veselin Vllahoviç, i njohur edhe si “Batko”, i lindur në datën 03 korrik të vitit 1969 në Nikshiq, Mali i Zi, është kriminel i luftës, në krimet e të cilit përfshihen dhunimet, paraburgimi i paligjshëm dhe tortura ndaj boshnjakëve dhe kroatëve në vendbanimin sarajevas Gërbavica në periudhën prej vitit 1992 deri në vitin 1995. Disa nga dëshmitarët e kanë njohur edhe më herët si boksier të Klubit Zheljezniçar, dhe si kujdestar të rendit në klubin sarajevas Sloga.¹⁰² Në gjykim është konstatuar se Vllahoviç di shkrim-lexim, se është me shkollë fillore të kryer, se është i pa profesion dhe i papunë, si dhe se është me gjendje të dobët pronësore. Po ashtu është vërtetuar se nuk e ka kryer shërbimin ushtarak, se është pa gradë ushtarake, si dhe se ka qenë edhe më herët i dënuar¹⁰³ (Vllahoviç e ka vuajtur dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tri vitesh për shkak të banditizmit dhe sjelljes së dhunshme, por në vitin 2001 ka ikur nga Shtëpia ndëshkues-përmirësues në Supzh të Malit të Zi). Më vonë ka jetuar në Spanjë, ku ka qenë në kërkim për tri plaçkitje të armatosura në krahinën Alicante. Në datën 2 mars të vitit 2010 është

burgosur, kurse, pas arratisjes shumëvjeçare, në bazë të kërkesës së Prokurorisë së B dhe H, në datën 26.08.2010 i është dorëzuar drejtësisë së Bosnjës dhe Hercegovinës nga Mbretëria e Spanjës.¹⁰⁴

Aktakuza¹⁰⁵

Pas lëshimit të urdhër-arrestit, Prokuroria e Bosnjës dhe e Hercegovinës, në datën 17 shkurt të vitit 2011 e ka ngritur aktakuzën¹⁰⁶ kundër Veselin Vllahoviçit, e cila është konfirmuar në datën 24 shkurt të vitit 2011, si dhe aktakuzën e dytë¹⁰⁷ të datës 25 maj të vitit 2011, të konfirmuar në datën 31 maj të vitit 2011. Prokuroria ka hequr dorë prej disa pikave të caktuara të aktakuzës, kurse aktakuza e ndryshuar dhe e bashkuar, Vllahoviçin e ka ngarkuar për kryerjen veprës penale të krimeve kundër njerëzimit si dhe se në kuadër të ndjekjeve mbi bazën kombëtare, etnike dhe fetare ka kryer: privim ose heqje nga jeta (vrasje), dërgim në skllavëri, dhunim, paraburgime të paligjshme, keqtrajttime fizike dhe psikike (sjellje çnjerëzore), plaçkitje si dhe zhdukje të dhunshme të popullatës civile joserbe.¹⁰⁸

Shqyrtimi kryesor dhe aktgjykim i shkallës së parë

Në seancën për deklarim mbi fajësinë, në datën 24 mars të vitit 2011, i akuzuari Veselin Vllahoviç është deklaruar se nuk është fajtor. Pas deklarimit lidhur me fajësinë, ka filluar procedura e provave e prokurorisë.

PROVAT E PARAQITURA

Dëshmitarët e Prokurorisë	Provat Materiale të Prokurorisë	Dëshmitarët e Mbrojtjes	Provat Materiale të Mbrojtjes	Provat e Gjykatës
114	201	19	43	0

101 Prokurori kundër Veselin Vllahoviçit, D1 1 P 004659 11, Gjykata e B dhe H, X-PP-05/70 (Gjykata e B dhe H).

102 Sipas deklaratave të dëshmitarit: „D-47“, „D39“, Hasiba Zajkoviç, „D-7“, „D-38“, Kenan Çengiç, „A-1“ dhe Nijaz Alihoçhiç, si dhe Vendimi mbi regjistrimin e Veselin Vllahoviçit si garues në Klubin e boksit „Zheljezniçar“ i datës 17.12.1987.

103 Më shumë të dhëna biografike janë në dispozicion në aktgjykimin: http://www.sudbih.gov.ba/files/docs/presude/2013/4659_1K_VV_prvostupanjaska_29_03_2013.pdf.

104 Për më shumë hollësi shih në: <http://www.tuzilastvobih.gov.ba/index.php?id=910&jezik=b>.

105 Aktakuza e Prokurorisë së B dhe H numër T20 0 KTRZ 0000852 05 e datës 17.10.2012.

106 Aktakuza e Prokurorisë së B dhe H numër: T20 0 KTRZ 0000852 05 e datës 17.2.2011.

107 Aktakuza e Prokurorisë së B dhe H numër: T20 0 KTRZ 0001205 11 e datës 25.5.2011.

108 Aktakuza e ngarkon Veselin Vllahoviçin për veprë penale të krimeve kundër njerëzimit nga neni 172, paragrafi 1, pika h) e Ligjit Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës (LPB dhe H) në lidhje me pikat a), c), e), g), i), k) dhe pikat f) të nenit 173, paragrafi 1, të gjitha në lidhje me nenin 180, paragrafi 1 i LP të B dhe H. Për më shumë, në dispozicion është: <http://www.sudbih.gov.ba/?opcija=predmeti&id=411&završen=1&jezik=b>.

Trupi gjykues, duke i vlerësuar provat, posaçërisht deklaratat e dëshmitarëve okularë, duke iu referuar parimit të vlerësimit të lirë të provave, e ka marrë parasysh faktin se ka kaluar një kohë e gjatë nga ngjarja deri te dëshmia dhe, së këndejmi, ka përfunduar se në rast të mospërputhjes midis deklaratës drejtpërdrejtë të dhënë para trupit gjykues dhe deklaratave të dhëna pas ngjarjeve, nuk do të kundërshtohet vërtetësia e dëshmisë, nëse është fjala për deviacione periferike. Duke iu referuar të drejtës obligative ndërkombëtare në Bosnjë dhe Hercegovinë, si dhe përkufizimit ligjor të veprës penale të Krimeve kundër njerëzimit¹⁰⁹, trupi gjykues ka vërtetuar se kjo veprë penale përmban tri elemente, të cilat në mënyrë kumulative duhet të plotësohen:

1. Ekzistimi i sulmit të gjerë ose sistematik

Trupi gjykues, duke vlerësuar ekzistimin e këtij kushti, i është referuar përkufizimit të gjerësisë ose karakterit sistematik të sulmeve, të krijuar nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (GJPNJ) në lëndën Prokurori kundër Kunarcit dhe të tjerëve¹¹⁰, si dhe Prokurori kundër Kordiqit dhe Çerkezit¹¹¹, ku Gjykata ka konstatuar se fjala *i gjerë* do të thotë „aksione masive, të shpeshta, të përmasave të mëdha të zbatuara në mënyrë kolektive me seriozitet të dukshëm dhe të drejtuara kundër një numri të madh të viktimave“, kurse koncepti i sistematikes mund të përkufizohet si „model i organizuar në mënyrë të themeltë dhe të rregullt i bazuar në politikën e përbashkët me mjete të dukshme publike ose private“.

Trupi gjykues ka përfunduar se në periudhën relevante të aktakuzës, përkatësisht për periudhën nga muaji maj i vitit 1992 e deri në fund të muajit korrik të vitit 1992, ka ekzistuar sulmi i gjerë dhe sistematik, i cili, nga provat me radhë të paraqitura, ka vazhduar edhe pas kësaj periudhe, kurse ka qenë ekskluzivisht i drejtuar kundër popullatës civile boshnjake dhe kroate, duke e vënë në pah se si në atë kohë janë vënë barrikatadat në rrugët kryesore të Sarajevës, se si Sarajeva ka qenë në mënyrë intensive e granatuar si dhe se “Kuvendi i Republika Srpskës i datës 12.05.1992 ka urdhëruar themelimin e Ushtrisë së Republika Srpska dhe e ka emëruar gjeneral Ratko Mlladiqin si Shef të Shtabit

të Përgjithshëm, që në datën 22.05.1992 e ka urdhëruar themelimin e Korpusit sarajevas - të romanis“. Po ashtu, trupi gjykues i është referuar deklaratave të një numri të madh të dëshmitarëve. Dëshmitarët kanë pohuar se si ka ekzistuar gjendja e izolimit të përgjithshëm pas ardhjes së formacionit paramilitar „Shqiponjat e bardha“ në Gërbavicë. „Trupi gjykues në mënyrë të padyshimtë ka vërtetuar ekzistimin e sulmit të gjerë dhe sistematik në zonën e qytetit të Sarajevës, posaçërisht në vendbanimin Gërbavica.“

2. Statusi i personave kundër të cilëve është drejtuar sulmi – civilët

Trupi gjykues i citon Konventat e Gjenevës si burim obligativ ndërkombëtar të të drejtave në Bosnjë dhe Hercegovinë, burim sipas të cilit civilët janë të mbrojtur gjatë kohës së konflikteve dhe armiqësive të armatosura. Trupi gjykues ka vërtetuar se si të gjithë të dëmtuarit, të cilët në këtë lëndë kanë qenë në cilësi të dëshmitarëve të prokurorisë, kanë qenë civil. Vihet në pah se si në mënyrë të padyshimtë është provuar se si në civilët është shtënë në mënyrë të qëllimshme derisa civilët i kanë kryer aktivitetet e tyre. Po ashtu, vihen në pah shembuj të caktuar të sulmeve mbi civilët, siç është granatimi i spitalit Koshevo, Spitalit Shtetëror, si dhe aktivitetet e snajperistëve të drejtuara kundër civilëve në Sarajevë. Trupi gjykues ka vërtetuar se është plotësuar edhe kushti i dytë.

3. I akuzuari ka qenë në dijeni për sulmin dhe veprat e tij janë pjesë e sulmit (nexus)

Edhe pse disa dëshmitarë të caktuar kanë pohuar se Vllahoviçi ka qenë pjesëtar i njësisë „Engjëjt e bardhë“, kjo nuk është vërtetuar në mënyrë të padyshimtë. Megjithëkëtë, në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se të akuzuarit i janë lëshuar uniforma dhe armatimi, si dhe se ka qëndruar në vendbanimin Gërbavica. Trupi gjykues ka vërtetuar se Vllahoviçi ka qenë pjesëtarë i forcave, të cilat kanë kryer sulm të gjerë dhe sistematik. Gjykata, në bazë të ekspertizës psikiatrike, të kryer nga ana e ekspertës dr. Zorica Llazareviçi, ka vërtetuar se në kohën e kryerjes së veprave, të cilat Vllahoviçit i vihen në barrë, ai ka qenë i përgjegjshëm,

109 Neni 172 i Ligjit Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës.

110 Prokurori kundër Kunarcit dhe të tjerëve [2015] MKSJ, IT-96-23/1-PT (MKSJ).

111 Prokurori kundër Kordiqit dhe Çerkezit GJPNJ, IT-95-14/2-T (GJPNJ).

me fjalë të tjera ka qenë i ndërgjegjshëm për veprat e tij dhe për pasojat e tyre si dhe ka dashur që të njëjtat të jenë pjesë e sulmit, i cili është zhvilluar në mënyrë sistematike.

Persekutimi i popullatës jo-serbe i kryer me vepër tjetër penale dhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë

Gjykata e ka trajtuar çështjen e ekzistimit të persekutimit të cilitdo grup të njerëzve ose kolektiveve mbi baza të palejueshme. Duke e trajtuar këtë çështje, trupi gjykues i është referuar dokumenteve dhe standardeve ndërkombëtare, duke e theksuar posaçërisht praktikën e GJPNJ-së. Trupi gjykues, në bazë të fakteve, në mënyrë të pakundërshtueshme ka vërtetuar se Vllahoviçi ka kryer persekutimin në bazë kombëtare dhe fetare, me anë të vrasjeve, me dërgimin në skllavëri, me paraburgimet e paligjshme, me torturat, me dhunime, me zhdukjen e përdhunshme të personave, me veprat e tjera çnjerëzore si dhe me anë të plaçkitjes së pronës. Trupi gjykues, me deklaratat e dëshmitarëve të mbrojtur, ka vërtetuar se Vllahoviçi persekutimin e ka kryer me anë të plaçkitjes së të dëmtuarve, me anë të dhunimit, me dërgimin në skllavëri të të dëmtuarve, me anë të vrasjeve dhe me mënyrat e cekura të veprimeve e ka vërtetuar përgjegjësinë e tij individuale penale. Akuza ka nxjerrë një numër të madh të dëshmitarëve-të të dëmtuarve, të dëshmuarit e të cilëve ka qenë provë themelore, me të cilin është drejtuar Gjykata. Duhet të theksohet se numri i vogël i deklaratave të dëshmitarëve nuk është konsideruar si i mjaftueshëm me qëllim që trupi gjykues në mënyrë të padyshimtë të konstatojë përgjegjësinë e Vllahoviçit dhe, në ato raste, në bazë të parimit in dubio pro reo e ka liruar lidhur me pretendimet e caktuara¹¹². Trupi gjykues i shkallës së parë e ka dënuar Veselin Vllahoviçin me dënimin afatgjatë në kohëzgjatje prej 45 vitesh.

Modeli unik i sjelljes së Veselin Vllahoviçit dhe keqtrajtimi i viktimave

Siç është cekur, në këtë lëndë deklarata ka dhënë një numër

i madh i dëshmitarëve – civil, të cilët e kanë përjetuar ferrin e Gërbavicës. Nga të gjitha deklaratat, Trupi gjykues ka mundur për të përfunduar se ka ekzistuar një varg i sjelljeve të kryera nga ana e Veselin Vllahoviçit, sipas të cilave ai është dalluar nga të tjerët. Së këndejmi, në bazë të deklaratave të dëshmitarëve është vërtetuar ekzistimi i një modeli unik të sjelljes së Vllahoviçit – si të sjelljeve, të cilat kanë të bëjnë me reputacionin e tij, me pamjen dhe me rrobat, të cilat i ka veshur, ashtu edhe modeli unik i abuzimit dhe i keqtrajtimit të popullatës së Gërbavicës. Kështu, shumica e dëshmitarëve të të akuzuarit Vllahoviç, atë e përshkruan si person i cili shfaqet në Gërbavicë në fillim të muajit maj të vitit 1992, në anën e ushtrisë serbe.¹¹³ Dëshmitarët e tjerë nuk e kanë njohur më parë, por kanë dëgjuar rrëfime sipas të cilave „aso kohe e gjithë Gërbavica ka shushuritur për njeriun monstruoz i cili i viziton shtëpitë, plaçkit, dhunon dhe vret“.¹¹⁴ Vllahoviçi e ka bartur vulën dalluese sipas kapelës së tij të zeze - „shajkaqës“, të cilën e ka bartur aso kohe dhe të cilën e bartë edhe në video spotin, i cili ka qenë shfaqur në Stacionin e TV „Srna“, në të cilin Vllahoviçi, me disa persona, qëndron në barrikadë me flamur, mban armatim automatik dhe i tregon tre gishtërinjtë, kurse në kokë e ka „shajkaqën“. Dëshmitarët thonë se Vllahoviçi ka shkuar nga Gërbavica me një Golf të bardhë dhe se ka pasur një thikë të gjatë.¹¹⁵ Një nga karakteristikat e tij ka qenë edhe qasja universale ndaj të dëmtuarve, kërcënimet me „therje“ ose me „vrasje“, kërkimi i „shpërblimit për jetën“, si dhe të cekurit e „përroit“, në të cilin do t'i dërgoj viktimat me qëllim të likuidimit.¹¹⁶ Njërit dëshmitarë, duke ia vënë thikën nën fytyrë dhe duke e kërcënuar se do ta ther, i ka thënë „ti do të më jesh i 87-ti sipas radhës!“.¹¹⁷ Dëshmitarët e kanë pohuar se Vllahoviçi viktimave të veta iu është kërcënuar me dërgimin në Trebeviç (bjeshkë e cila gjendet jo larg nga vendbanimi sarajevas Gërbavica), vend në të cilin një numër i madh i viktimave të tij janë zhvarrosur. Dëshmitari Nijaz Alihoxhiçi ka thënë „M'i ka kërkuar 10.000,00 DM që t'ia jap dhe nuk do të më pres. Kur kemi shkuar në Trebeviç, mbi njëfarë grope, unë e kam ndjerë një shije të pakëndshme, kurse

112 Është fjala për deklaratat e dëshmitarit, që nuk kanë fuqi dëshmuuese, duke përjashtuar secilin dyshim të arsyeshëm, që të mund të nxirrite përfundimin kundër Vllahoviçit, ose për deklarata të papëruptshme të më shumë dëshmitarëve mbi të njëjtën ngjarje.

113 Sipas deklaratave të dëshmitarëve: „D-35“, „D-36“, „D-13“, „D-47“, „Muhamed Shehiq, „D-39“, „D-5“, Rasim Torlak, „D-24“, „D-28“, „D-43“ dhe „D-10“.

114 Deklaratë e dëshmitares Razija Durakoviçi.

115 Deklaratë e dëshmitarit: Denis Suliq, „D-5“, „D-16“, „D-25“, „D-11“, Gjevdet Delaliq.

116 Deklarata të dëshmitarëve: „D-16“, „D-6“ i „D-21“.

117 Deklaratë e dëshmitarit „D-21“.

ai më ka thënë se pikërisht aty ka prerë shumë bali!“ Edhe dëshmitarët e tjerë flasin se si iu është kërcënuar Vllahoviqi me „dërgimin në përrua“.¹¹⁸

Dhunimin kryesisht e ka kryer në banesat e të dëmtuarve, të cilat pas kësaj edhe i ka plaçkitur, kurse disa prej viktimave i ka dërguar në banesën e tij në Vracama.¹¹⁹ Viktimat e dhunimit e kanë theksuar se Vllahoviqi i ka lidhur me zinxhirë dhe me pranga për radiator, si dhe i ka ngujuar në banesë¹²⁰. Dëshmitarët „D-11“ dhe „D-29“, të cilat në kuadër të radhës së punës disa herë kanë pasur rastin për të pastruar banesën e të akuzuarit, pohojnë se kur kanë shkuar në banesë pothuajse gjithmonë kanë hasur në gjurmë të gjakut dhe të urinës, derisa dëshmitarët „D-1“, „D-6“ dhe „D-11“ në të njëjtin edhe i ka dhunuar. Disa viktimave Vllahoviqi iu ka thënë që ta quajnë me emrin „Dragan“¹²¹, me qëllim që ta fsheh identitetin e tij. Megjithatë, ushtarët, të cilët kanë qenë në shoqëri me te e kanë quajtur me emrin „Batko“, si edhe për arsye se në Gërbavicë në atë periudhë ka qenë e njohur mënyra me të cilën egërsisht i ka keqtrajtuar viktimat, për çka edhe nuk ia ka dalë me fshehjen e identitetit.

Procedura sipas mjeteve juridike dhe vendimi i panelit ankimor

Të dyja palët në procedurë në kohë i kanë deklaruar ankesat për shkak të gjendjes faktike gabimisht dhe në mënyrë të paplotë të vërtetuar. Prokuroria e ka deklaruar ankesën sipas së cilës trupi gjykues nuk i ka vlerësuar në mënyrë të rregullt provat e paraqitura, të cilat kanë pasur të bëjnë me 6 pika të aktakuzës, për të cilat është liruar i akuzuari. Prokuroria e ka vënë në spikamë se trupi gjykues gabimisht i ka vlerësuar deklaratat e dëshmitarit Shefik Menziloviqit. Paneli ankimor këtë pretendim e konsideron të pabazuar, nga arsyeja se deklaratat e dëshmitarit nuk e ka vërtetuar faktin me siguri të plotë. Më tutje, Prokuroria e ka cekur se si trupi gjykues gabimisht i ka vlerësuar deklaratat e dëshmitarëve A-25, Zoran Kataniqit, Gjorgje Nedeljkoviqit dhe Dragoljub Gjukanoviqit. Paneli ankimor i ka refuzuar këto pretendime si të pabazuara. Mbrojtësit e Vllahoviqit e kanë kontestuar aktgjykimin për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës

penale – gjendjes faktike gabimisht dhe në mënyrë të paplotë të vlerësuar, duke e vendosur kërkesën në mënyrë alternative: anulimin e aktgjyimit të shkallës së parë dhe mbajtje të sërishme të shqyrtimit kryesor ose shqiptim të sanksioneve më të buta për Vllahoviqin. Mbrojtja konsideron se trupi gjykues „gabimisht e ka vërtetuar gjendjen faktike në pikëpamje të ekzistimit të sulmeve gjerësisht të përhapura dhe sistematike“. Mbrojtja e ka argumentuar këtë pohim duke pretenduar se si në periudhën kur Vllahoviqi i ka kryer veprat penale ka ekzistuar konflikti i të dyja palëve dhe jo sulm sistematik i njëres palë. Paneli ankimor e ka refuzuar këtë pretendim si të pabazuar. Mbrojtja ka kontestuar se i akuzuari ka qenë në dijeni për sulmin dhe se veprat e tij janë pjesë e sulmit. Mbrojtja ka theksuar se si nuk është provuar se Vllahoviqi ka qenë pjesëtarë i formacionit paramilitar „Shqiponjat e bardha“, si edhe i cilëso njësi tjetër paramilitare si dhe se, së këndejmi, nuk është provuar qëllimi diskriminues gjatë persekutimit, duke pohuar se si Vllahoviqi i ka kryer veprat e caktuara penale edhe ndaj pjesëtarëve të popullit serb dhe atë duke iu referuar asaj se si Vllahoviqi i ka dhunuar edhe femrat e kombësisë serbe. Pretendimet e mbrojtjes të cekura në ankesë, me përjashtim të pretendimeve të pikës 12 të pjesës liruese të aktgjyimit, janë refuzuar si të pabazuara.

Paneli ankimor e ka shqyrtuar pretendimin e mbrojtjes sipas të cilit Vllahoviqi i është shkelur e drejta në mbrojtje, posaçërisht duke theksuar se si Vllahoviqi nuk ka pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes. Kështu, mbrojtja i është referuar mospërputhjes midis deklaratave të dëshmitarëve të Prokurorisë të dhëna menjëherë pasi që kanë ndodhur ngjarjet dhe deklaratave me gojë para trupit gjykues të shkallës së parë. Mbrojtja edhe më tutje e ka vënë në pyetje paanashmërinë e trupit gjykues si dhe kredibilitetin e disa dëshmitarëve të caktuar, sepse trupi gjykues i shkallës së parë ia ka ndaluar mbrojtjes për t'i shtruar pyetje të caktuara atij dëshmitari. Llazareviqi në këtë pjesë të ankesës ka cekur edhe shumë shembuj individual në lidhje me dëshmitë e dëshmitarëve – viktimat të dhunimit. Nga ana tjetër, disa autorë i theksojnë pohimet e kundërta,

118 Deklarata të dëshmitarëve: „D-47“, „D-35“, „D-36“ dhe „D-29“.

119 Paragrafi 61 i aktgjyimit.

120 Deklarata të dëshmitarëve „D-6“, „D-1“ dhe Manuela Kreshiq.

121 Deklarata të dëshmitarëve: „D-6“ dhe „D-8“.

duke pohuar se si dëshmitarët e mbrojtur – viktimat të dhunës seksuale nuk kanë qenë mjaft të mbrojtur si dhe se, me gjithë faktin se është mundësuar që dëshmitë e tyre të incizohen me mjete audio vizuale, fytyrat e tyre kanë qenë të dukshme kur deklaratat është prezantuar para gjykatës.¹²²

Pjesa e ndryshuar e aktgjykimit – pika e 12 e pjesës ndëshkuese

Trupi gjykues i shkallës së parë me pikën 12 e ka dënuar Vllahoviçin për kryerjen e persekutimit me vrasjen e Zlatko Salçinit. Mbrojtja ka theksuar se deklaratat e dëshmitarit Esad Çoho dhe dëshmitarit D-37 dallojnë thelbësisht.

Përndryshe, sipas deklaratës së dëshmitarit Esad Çoho, të dëmtuarin Zlatko Salçin e kanë arrestuar pjesëtarët e „Shqiponjave të bardha“, kurse sipas deklaratës së dëshmitares D-37 këtë e ka bërë Vllahoviçi. Megjithëkëtë, paneli ankimor e ka vënë në spikamë se si dëshmitarja D-37 nuk mundet me siguri për të pohuar se në mesin e personave, të cilët e kanë arrestuar të dëmtuarin, ka qenë edhe Veselin Vllahoviçi. Po ashtu, bashkëshortja e Esad Çohos në shënimet zyrtare të dhëna agjencisë Shtetërore për hetime dhe mbrojtje të datës 04.01.2011 ka deklaruar se si Veselin Vllahoviçi „nuk ka asgjë“ me arrestimin e burrit të saj. Trupi gjykues ka përfunduar se si Prokuroria i ka parashtruar provat, të cilat kanë të bëjnë me arrestimin e të dëmtuarit, por jo edhe ato në bazë të të cilave mund të vërtetohet se Vllahoviçi ka marrë pjesë në vrasjen e tij, arsye kjo pse konstaton se nuk është provuar se Vllahoviçi e ka kryer këtë vepër penale. Trupi gjykues ka qenë i mendimit se anulimi i aktgjykimit vetëm në lidhje me njëren pikë do të zvarriste në mënyrë plotësuese procedurën dhe, së këndejmi, ka vendosur për ta modifikuar aktgjykimin në lidhje me këtë pikë. Paneli ankimor e ka theksuar se si, me rastin e matjes së lartësisë së dënimit, krahas qëllimit të dënimit, dënimin është e nevojshme për ta llogaritur në atë mënyrë, e cila merr parasysh edhe rrethanat vështirësuese e edhe ato lehtësuese.

Rrethana vështirësuese janë:

1. Modeli i sjelljes së Vllahoviçit: i parë në: „sasinë dominuese dhe të pazakonshme kriminale, e cila është e manifestuar me brutalitet dhe mungesë tmerruese të skrupujve“;
2. Pasojat, të cilat veprimet e tij i kanë lënë në viktimat si dhe në familjet e tyre, por edhe në popullatën e vendbanimeve Gërbavica, Vraca dhe Kovaçiqi;
3. Rrethanat e atmosferës: „...frikës, pashpresës, pasigurisë së viktimave,“ të cilat në mënyrë evidente i ka shfrytëzuar i akuzuari me qëllim që të manifestojë epërsinë e tij;
4. Intensiteti i rrezikimit dhe shkelja e të mirave të mbrojtura është i shprehur në lidhje me të akuzuarin dhe
5. Dënueshmëria e mëhershme e Veselin Vllahoviçit.

Paneli ankimor ka vërtetuar se nuk ekzistojnë rrethana lehtësuese, të cilat do të ndikonin në zvogëlimin e dënimit në rastin konkret.¹²³ Megjithëkëtë, gjatë matjes së dënimit është marrë parasysh edhe ajo se Vllahoviçi është liruar për pikën 12 të pjesës ndëshkuese të aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata në fund i ka nxjerrë konkluzionet në bazë të deklaratave të dëshmitarit Aresni Shkipinit se gjatë kohës së kryerjes së veprave penale Veselin Vllahoviçit ka ekzistuar stacioni i policisë Sarajeva e Re (Novo Sarajevo), me departamentin për luftimin e kriminalitetit. Më tutje, dëshmitari ka deklaruar se ka arritur informacioni nga ministria e punëve të brendshme që të burgoset „Batko“, e megjithëkëtë i njëjti ka ikur pak para se informacioni të ketë arritur. Paneli ankimor ka ardhur te konkluzioni se Vllahoviçit heshturazi i është miratuar kryerja e shumë veprave penale dhe atë me qëllim të sulmit sistematik dhe të gjerë. Paneli ankimor e ka dënuar Veselin Vllahoviçin me dënim afatgjatë në kohëzgjatje prej 42.

122 Aldina Muslija, „Të mbijetuarit e harruar: Një rast studimi mbi qasjen ndaj Drejtësisë dhe Mjeteve juridike për Viktimat e Dhunës Seksuale në Bosnjë dhe Hercegovinë“ (The Forgotten Survivors: A Case Study on Access to Justice and Remedies for Victims of Sexual Violence in Bosnia and Herzegovina.)” 2013, 56, në dispozicion në: [http://goja.ceu.hu/search~S0/X?aldina muslija&SORT=D](http://goja.ceu.hu/search~S0/X?aldina%20muslija&SORT=D).

123 Paragrafi 724.

Përfundim:

Veselin Vllahoviç Batko nuk është simbol i trimërisë ose dikush në të cilin kushdo qoftë do të krenohet. „Monstrumi nga Gërbavica“ – siç e kanë quajtur, kurrë nuk ka marrë pjesë në kurrfarë aksioni ushtarak si dhe as që ka qenë formalisht anëtar i cilitdo formacion ushtarak ose paramilitar, edhe pse emri i tij është lidhur me disa formacione të caktuara. Me një arsimim modest dhe me një sjellje të dhunshme, ka qenë pikërisht mjet për realizimin e një plani më të madh. Përfundimi i Gjykatës së B dhe H se si në mënyrë të heshtur Vllahoviçit i janë miratuar kryerja e të gjitha krimeve me qëllim të sulmit sistematik në të vërtetë e tregon se ai ka qenë i instrumentalizuar nga ana e atyre, të cilët ia kanë miratuar veprimet e tilla. Në mbështetje të kësaj flet edhe aktgjykimi, ku është vërtetuar se ka kryer krime ndaj civilëve të pafuqishëm. Batko i egër dhe brutal, i cili ka lëvizur ato vite nëpër vendbanimin sarajevas të Gërbavicës, ka qenë frika më e madhe e popullatës në atë periudhë, e pas kësaj trauma e tyre e përjetshme. Edhe pse i është miratuar kryerja e krimeve, ai nuk ka qenë dikush të cilit i është besuar sjellja e vendimeve të as farë rëndësie për sukseset e „Engjëjve të bardhë“ ose të cilësdo njësi paramilitare ose militare, anëtar ose bashkëpunëtor i të cilës ka qenë. Qëllimi i veprimtarisë së tij ka qenë mbjellja e frikës dhe e panikut tek popullata. Ai, si individ, nuk ka qenë i domosdoshëm për arritjen e qëllimeve, por ajo çfarë ka bërë ai gjithsesi se po. Duke e pasur

parasysh se një nga mekanizmat e drejtësisë tranzicionale është edhe ndjekja penale, miratimi i një aktgjykimi të këtillë është jashtëzakonisht i rëndësishëm, por edhe i ndryshëm nga aktgjykimet dënuese për individët udhëheqës. Rëndësia e këtij aktgjykimi shihet, midis të tjerash, edhe në dënimin e asaj që Vllahoviçit e ka përfaqësuar – të të gjithë asaj prej të cilës popullata e Gërbavicës dhe e vendbanimeve përreth është frikësuar. Aktgjykimi për „Monstrumin nga Gërbavica“, ashtu siç e kanë quajtur, përbënë një satisfaksion të pjesshëm për qindra viktimat e tij, por në të njëjtën kohë nuk lë kurrfarë pasojash në ata, të cilët ia kanë mundësuar që të jetë mbret i jetës dhe i vdekjes në atë periudhë. Kur është fjala për reparacionet, Gjykata, të gjithë të dëmtuarit të përfshirë në këtë lëndë i ka udhëzuar për padi gjyqësore. Edhe pse nuk kemi më shumë informacione mbi kërkesat pronësore juridike, është pak e besueshme se të dëmtuarit kërkesat e tyre mund t'i realizojnë, duke pasur parasysh se Batko ka qenë i një gjendjeje të dobët pronësore.

Veselin Vllahoviç ndodhet në vuajtje të dënimit afatgjatë në Entin ndëshkues-përmirësues të Foçës. Vendimi mbi vuajtjen e dënimit në ENP ka hasur në kundërshtim të madh në publik, për shkak të mundësisë që Vllahoviçit atje të trajtohet si hero si dhe për shkak të faktit se është fjala për të njëjtin institucion nga i cili ka ikur Radovan Stankoviç kur ka qenë në vuajtje të dënimit për krime të luftës dhe ka qenë në arrati plot 5 vite.

Drejtësia tranzicionale në Serbi

Kompensimet e dëmeve për torturimin dhe trajtimin çnjerëzor në kampet e Republikës së Serbisë:

Studimi i rastit *Shljivovica* dhe *Mitrovo Polje*

Miodrag Pantović

Hyrje

Qëndrimi zyrtar i ish Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) si dhe Republikës së Serbisë gjatë konflikteve të luftës në territoret e Bosnjës dhe Hercegovinës (B dhe H) në periudhën kohore 1992-1995 ka qenë që RFJ nuk është palë pjesëmarrëse e konfliktit të armatosur dhe se gjendej në gjendjen e luftës së tërthortë, kurse autoritetet e RFJ janë të obliguara që t'i respektojnë të gjitha të drejtat dhe zakonet e luftës në rast se do të rezultonte deri te shpërthimi i konflikteve të luftës në territorin e RFJ-së. Dhe njëmend, konflikte të drejtpërdrejta ushtarake në territorin e RFJ-së dhe, me vet këtë, edhe në Serbi nuk ka pasur, pos incidenteve sporadike në zonat kufitare, posaçërisht në rajonin e Drinës. Megjithatë, gjatë vitit 1992, posaçërisht në vitin 1993 rezultoi deri te një varg shkeljesh të rënda të të drejtave të njeriut të popullatës civile boshnjake në zonat kufitare nga drejtimi i B dhe H në territorin e RFJ-së, të kryera nga ana e serbëve të Bosnjës dhe e Ushtrisë së Jugosllavisë (UJ). Shembujt më të qartë i përbëjnë shkatërrimi i fshatit Kukuroviq në komunën Pribojit në Serbi, si dhe i fshatit Bukovica në komunën e Pljevljes në Mal të Zi. Po ashtu ka rezultuar edhe deri te kidnapimet, zhdukja dhe vrasja e civilëve të kombësisë boshnjake, qytetarëve të RFJ-së dhe Serbisë në zonën kufitare me B dhe H nga ana e formacioneve paramilitare të serbëve boshnjak (rastet Sjeverin dhe Shtpce). Një nga format më të rënda të

shkeljes së të drejtave të njeriut ka qenë edhe parburgosja masive, kurse më vonë edhe deportimi i civilëve boshnjak nga formacionet policore dhe ushtarake të Republika Srpska nga Policia e Malit të Zi gjatë pranverës së vitit 1992, pas të cilave shumicës së personave të deportuar i humbet çdo gjurmë. Nga viti 2006, të mbijetuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre kanë iniciuar procedura të kompensimit të dëmit para gjykatave në Mal të Zi, prej të cilave shumica në momentin e shkrimit të këtij punimi nuk ka qenë të përfunduara¹²⁴.

Gjatë muajit korrik të vitit 1995, pas rënies së zonave të mbrojtura të Srebrenicës dhe Zhepës, rezultoi deri te sjellja çnjerëzore dhe shkelja masive e të drejtave të njeriut të civilëve të shpërngulur boshnjak, të cilët në numër të madh kishin ikur në territorin e RFJ-së. Në atë periudhë, pas kalimit të vijës së kufirit të Serbisë dhe B dhe H, një numër i madh i civilëve boshnjak janë burgosur dhe vendosur në qendra private në territorin e Serbisë dhe pas kësaj i janë ekspozuar sjelljeve çnjerëzore gjatë qëndrimit në kampe edhe pse zyrtarisht nuk kanë qenë pjesëmarrës në luftë, shteti i Serbisë, i cili as që e kishte njohur ndërkombëtarisht B dhe H, duke u sjellë në mënyrë çnjerëzore ndaj refugjatëve boshnjak, i ka shkelur, si normat ligjore vendore, ashtu edhe ato ndërkombëtare, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e refugjatëve dhe të personave të ekspozuar persekutimeve gjatë kohëzgjatjes së konfliktit të armatosur dhe atë para së

124 Në dispozicion në http://www.prelevic.com/human_rights_deportacija.htm, qasur në muajin shkurt të vitit 2015.

gjithash Konventën e Gjenevës mbi Statutin e refugjatëve të vitit 1951 si dhe Protokollin e New Your-kut mbi statusin e të njëjtëve të vitit 1967¹²⁵, si dhe dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Serbisë¹²⁶ të vitit 1990, dhe të Kushtetutës së RFJ-së të vitit 1992¹²⁷. Po ashtu, është shkelur edhe protokollin i Konventës së Gjenevës mbi mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura ndërkombëtare, nënshkruar në cilës, në atë moment, ka qenë, si shtet trashëgimtar i RSFJ-së, RFJ.¹²⁸ Për shkak të torturës fizike dhe psikike, të cilës i janë ekspozuar gjatë qëndrimit në kampe, një numër i viktimave e ka iniciuar procesin për kompensimin e dëmit, i cili me gjithë rezistencat e mëdha procesore, zvarritjet e kontestimeve dhe qëndrimin e përgjithshëm negativ ndaj mekanizmave preparator, zgjat edhe më tutje para Gjykatës Themelore në Beograd.

Rënia e e enklavës së Zhepës dhe kampet Mitrovac dhe Shljivovica

Vendi Zhepa gjendet në territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës, në komunën e Rogaticës, menjëherë në afërsi të kufirit me Republikën e Serbisë, përkatësisht ish RFJ-në. Sipas të dhënave të regjistrimit të paraluftës të vitit 1991, Bashkësia Lokale e Zhepës ka pasur 2441 banorë prej të cilëve 95% kanë qenë mysliman/boshnjak¹²⁹. Me fillimin e luftës në B dhe H në muajin prill të vitit 1992, e posaformuara aso kohe Ushtria e Republika Srpska (URS), me ndihmën e Armatës Popullore të Jugosllavisë (APJ) dhe formacioneve paramilitare merr nën kontroll vendet përreth (Rogatica,

Vishegradi dhe Foça) duke kryer persekutimin, vrasjen dhe dëbimin e popullatës boshnjake gjë që rezultojnë që një pjesë e popullatës boshnjake nga këto anë të fshihet në Zhepë, kurse Zhepa, krahas Srebrenicës dhe Gorazhdës, bëhet një nga enklavat e tjera boshnjake në Bosnjën Lindore. Rrjedha e cekur e ngjarjeve të luftës rezultojnë deri aty sa që numri i popullatës së enklavës së Zhepës vullshëm rritet kështu që në atë hapësirë të vogël gjatë vitit 1993 banojnë midis 15000 dhe 20000 njerëz. Në muajin prill të vitit 1993, gjatë sulmeve të vazhdueshme të URS dhe situatës së rëndë humanitare, e cila mbretëronte në zonën e enklavës, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e sjellë vendimin mbi shpalljen e Zhepës së bashku edhe me katër (4) enklavat e tjera boshnjake zona të mbrojtura nën kontrollin e Forcave Mbrojtëse të Kombeve të Bashkuara (UNPROFOR)¹³⁰ dhe gjendja e tillë, me disa modifikime të caktuara, zgjat krejt deri në muajin korrik të vitit 1995.

Në muajin korrik të vitit 1995, URS e fillon operacionin me emrin „Krivaja” në hapësirën e zonave të mbrojtura të Srebrenicës dhe të Zhepës.¹³¹ Srebrenica bie qysh në datën 11 korrik. Megjithatë, ngjarjet në enklavën e Zhepës marrin një rrjedhë tjetër. Mbrojtja e enklavës njoftohet për krimet masive dhe gjenocidin i cili po zhvillohej në Srebrenicë dhe përpiqet për të prolonguar rënien e enklavës në mënyrë që të sigurojë më shumë kohë për tërheqjen e popullatës¹³². Në atë moment, në hapësirën e enklavës ndodhen sipas vlerësimeve prej 10000 deri 15000 njerëz.

125 Rregullorja mbi ratifikimin e konventës mbi statusin e refugjatëve me aktin përfundimtar të konferencës së autorizuarve të plotfuqishëm të Kombeve të Bashkuara mbi statusin e refugjatëve, Gazeta Zyrtare e RFPJ – Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe marrëveshjet e tjera nr. 7/60, Beograd, neni 3: „Shtetet nënshkruese do të zbatojnë dispozitat e kësaj konvente ndaj refugjatëve pa diskriminim në pikëpamje të rasës, besimit ose vendit të prejardhjes”.

126 Kushtetuta e Republikës së Serbisë, Gazeta Zyrtare RS 1-90, Beograd, neni 26: „Garantohet respektimi i personalitetit njerëzor dhe i dinjitetit në procedurën penale dhe në çfarëdo procedure tjetër, në rast të privimit përkatësisht kufizimit të lirisë si dhe gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit. Askush nuk guxon t’i nënshtrohet torturës, dënimit dhe sjelljes poshtëruese”.

127 Kushtetuta e Republikës Federative të Jugosllavisë, Gazeta Zyrtare e RFJ-së, viti I, 1/92, Beograd, neni 22: „Garantohet pacenueshmëria e integritetit fizik dhe psikik të njeriut, e privatësisë së tij dhe e të drejtave të tij personale. Garantohet dinjiteti personal dhe siguria e njeriut”.

128 Konventa e Gjenevës mbi sjelljen ndaj të burgosurve të luftës – Konventa e III-të e Gjenevës, Gazeta Zyrtare e RFPJ nr. 24/50, Beograd, neni 87, paragrafi 3: „Është i ndaluar çdo dënim kolektiv për vepra individuale, çdo dënim trupor, çdo mbyllje në hapësirat, të cilat nuk janë të ndriçuara me dritën e ditës dhe, në përgjithësi, çdo formë e torturës ose e egërsisë”.

129 “Përbërja nacionale e popullatës – Rezultatet për Republikën sipas komunave dhe vendbanimeve në vitin 1991.”, buletini statistikor nr. 234, Botim i Entit Shtetëror për Statistika të Republikës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Sarajevë 1991.

130 Rezoluta e Këshillit të Sigurimit nr. 824 (e qasshme në <http://www.refworld.org/cgi-bin/texis/vtx/rwmain?docid=3b00f16028>) pristupljeno: shkurt, 2015.

131 Prokurori kundër Tolimirit, Miletiqit dhe Gverës, lënda nr. IT’-04-80-PT, aktakuza e parë e ngritur në datën 10 shkurt të vitit 2005.

132 *Ibid.*

Me negociatat e URS me ndërmjetësimin e përfaqësuesve të ish kontingjentit ukrainas të UNPRFOR-it fillon evakuimi i grave, i fëmijëve dhe i pleqve në drejtim Klادنjës, që ndodhej nën kontrollin e forcave të Ushtrisë së Bosnjës dhe të Hercegovinës. Fatkeqësisht, gjatë negociatave, URS e shkel marrëveshjen dhe e kidnapon Avdo Paliqin, ish komandantin e mbrojtjes të enklavës dhe më vonë e privon atë nga jeta. Në datën 31 korrik të vitit 1995 pjesëtarët e URS e marrin enklavën plotësisht, derisa pjesa më e madhe e banorëve meshkuj, që nuk ishte fshehur në pyjet në rrethinë, në mënyrë që të depërtojnë deri te territori nën kontroll të Armatës së B dhe H, ik drejt lumit Drin, përkatësisht liqenit artificial Peruqac¹³³.

Zhepa e ka përbërë të vetmin territor nën kontrollin e Armatës së B dhe H, që gjendej menjëherë pranë kufirit me URS, prej të cilës e ka ndarë gryka e lumit Drin dhe liqeni Peruqac. Refugjatët nga Zhepa në gjendje e tyre të përgjithshme të pashpresë pas rënies së enklavës kanë konsideruar se me kalimin në territorin e RFJ do të jenë më të sigurt, sepse, midis të tjerash, në kufirin midis RFJ dhe B dhe H është gjendur edhe kontingjenti i vëzhguesve ndërkombëtar, kurse në RFJ në mënyrë aktive edhe misioni i Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK). Në grupin, i cili ka ikur, janë gjendur rreth 850 njerëz, në mesin e të cilëve edhe disa dhjetëra të mitur dhe dy (2) gra¹³⁴. Kalimi i refugjatëve është zhvilluar kryesisht në mënyrë kaotike dhe të paorganizuar me anë të përdorimit të barkave dhe të lundrave të improvizuara, kurse pjesa më e madhe e të ndjekurve e ka kaluar lumin gjatë granatimeve të shpeshta nga URS. Vet procesi i kalimit ka zgjatur disa javë nga fundi i muajit korrik e deri në mesin e muajit gusht të vitit 1995, derisa mbledhja, klasifikimi dhe seleksionimi i refugjatëve nga UJ është zhvilluar sipas një modeli të përcaktuar¹³⁵.

Gjatë kalimit të liqenit dhe ngritjes nëpër shkëmbinjtë vështirë të qasshëm të grykës së bjeshkëve Tara, të persektuarit kanë qenë të ndaluar nga pjesëtarët e UJ. Pjesëtarët e UJ rregullisht kanë kontrolluar refugjatët, shpesh duke ua marrë atyre gjërat e vlershme dhe ato të tjera personale, ndonjëherë edhe medikamentet dhe materialin mjekësor. Me rastin e kontrolleve të një grupi në bjeshkën Zvezda, pjesë e masivit të bjeshkës Tara, pjesëtarët e UJ pas maltretim të kanë vrarë Mujë Hoxhiqin nga Zhepa¹³⁶. Pas përfundimit të veprimit të cekur, refugjatëve iu është urdhëruar të qëndrojnë të ulur në tokë me kokën teposhtë, kurse pas kësaj, pjesëtarët e UJ e kanë bërë bartjen e refugjatëve deri te shkolla në fshatin Jagoshticë në komunën e Bajina Bashtës. Gjatë dërgimit deri te fshati Jagoshticë, shumë boshnjak janë rrahur dhe keqtrajtuar në mënyra të ndryshme poshtëruese dhe shpesh janë detyruar që ashtu të rraskapitur të vrapojnë deri te qendra e tubimit në Jagoshticë, e cila ka qenë disa kilometra në largësi nga vendi i kapjes. Kanë pasuar kontrolle të reja si dhe marrja e gjërave të çmueshme me anë të fyerjeve, sharjeve dhe keqtrajtmeve nga pjesëtarët e UJ. Refugjatët shpesh e kanë kaluar natën nën qiellin e hapur me duart në pozitën pas koke, krahas sjelljeve të tjera çnjerëzore¹³⁷. Pas kësaj ka rezultuar deri te transferimi i refugjatëve në qendrat e tubimit të formuara në Shjivovicë, komuna e Çajetinës, në një hapësirë të kazermave të shkatërruara të ndërmarrjes ndërtimore Planum, në të cilat deri në lëshimin e tyre kanë banuar rreth 400, dhe në fshatin Mitrovac, komuna e Aleksandrovcit, në hapësirën e ish pushimores së fëmijëve, në të cilën deri në fund të vitit 1996 kanë banuar rreth 450 njerëz¹³⁸. Transferimi deri te kampi është bërë me anë të kamionëve, derisa shpesh, gjatë hyrjeve në kamion, të burgosurit janë rrahur nga pjesëtarët e policisë ushtarake. Kamionët kanë qenë të stërmbushur, gjë

133 Prokurori kundër Tolimirit, Miletiqit dhe Gverës, lënda nr. IT'-04-80-PT, aktakuza e parë e ngritur në datën 10 shkurt të vitit 2005.

134 E qasshme në <http://www.hlc-rcd.org/?p=13128>; e qasshme në muajin shkurt të vitit 2015.

135 Fondi për të Drejtën Humanitare, *Reparacionet materiale për shkeljet e të drejtave të njeriut në të kaluarën - Praktika e gjykatave në Serbi* (Beograd-Fondi për të Drejtën Humanitare, 2011), f. 11-12.

136 Fondi për të Drejtën Humanitare, *Reparacionet materiale për shkeljet e të drejtave të njeriut në të kaluarën - Praktika e gjykatave në Serbi* (Beograd-Fondi për të Drejtën Humanitare, 2011), f. 12.

137 Fondi për të Drejtën Humanitare, *Reparacionet materiale për shkeljet e të drejtave të njeriut në të kaluarën - Praktika e gjykatave në Serbi* (Beograd-Fondi për të Drejtën Humanitare, 2011), f. 11-12.

138 Jelena Grujiq, "Ferri nën rojën e shtetit", *NIN: 3148*, 2011, e qasur në muajin shkurt të vitit 2015 në <http://www.nin.co.rs/pages/article.php?id=60586>.

që ka shkaktuar vdekjen e një personi si rezultat i ngufatjes, derisa shumë prej tyre e kanë janë alivanosur¹³⁹.

